

ekonomia

E enjte, Qershor 2009 - Kosovë



Organizata për Demokraci, Anti-Korruption dhe Drejtësi
ÇOHU!.org



Kosova C - Ku është interesi kombëtar?

Të luftosh sot për interesin kombëtar të Kosovës në projektin Kosova e Re, do të thotë të luftosh për t'i siguruar asaj dhjetëra miliardë

euro, të cilat shumë lehtë mund të shndërrohen në pazare me disa zero më pak, për ne."

faqe 3

Avni KURSHUMLIU

Një qasje tjetër për zhvillimin e energjetikës

Gjatë ndërtimit të TC Kosova B1 e 2, paralelisht ka qenë bërë projekti për ndërtimin e TC Kosova B 3,4,5 me ngarkesë secila nga 600 MWh e që në atë kohë quhej projekti i TC Kosova e madhe. Kuptohet ndërtimi ka qenë paraparë në faza sipas nevojës për energji. Në të njëjtën kohë zhvillohej ideja për një TC 2400 MWh, që atëherë quhej TC Kosova C e që duhej të ndërtohej diku në Lapna selo në drejtim të Ferizajt. Kosova C ishte planifikuar si një... [faqe 2](#)

Avni ZOGIANI

Një skenar i zi për PTK-në që rrezikon të aplikohet për kompanitë tjera publike

Ekziston një alibi gjeneral për privatizimin e kompanive me pronësi publike që përdoret nga institucione të rëndësishme ndërkombëtare: privatizimi duhet të ndodhë për shkak se kompanitë me status publik kanë probleme, nuk... [faqe 4](#)

Visar YMERI

Varësia nga shikimi jashtë

Kosova vlon nga anomalitë. Varfërinë e kemi 45% (me atë të skajshme në 18%), ndërkohë që njihemi si vend me pasuri të përqendruar dhe të shumtë nëntokësore (supozohet se vlera e përgjithshme e linjtit e përkthyer në rrymë elektrike është diku 70 miliardë euro, ndërsa kombinati Trepça vazhdon ta ketë nën tokë një shumë marramendëse të parave). Madje nuk kemi as rrymë elektrike. Papunësinë (zyrtare) e kemi 46%, ndërkohë që afërsisht... [faqe 5](#)

Albin KURTI

Përpara drejt feudalizmit

Miti më i ri i kapitalizmit - ai i të qenit të tij i globalizuar - ka pasur shumë sukses në Kosovë. Nga izolimi i gjatë dhe i dhunshëm, qytetarët e Kosovës e dëshironin dëshpërueshëm bërjen e tyre pjesë të botës. Globalizimi u përfytyrua si... [faqe 6](#)

Adem NIMANI

Privatizimi i ndërmarrjeve në Kosovë - dështimi në skenë të hapur

faqe 9

Safet GËRXHALIU

Privatizimi dhe Kosova

Është e vërtetë se tranzicioni në përgjithësi është një ndër proceset më të vështira me të cilin ballafaqohen shtetet të cilat kalojnë nëpër këtë proces dhe në raste të shumta... [faqe 8](#)

Besnik PULA

Kosova në krizën globale financiare

Është bërë e zakonshme nëpër medime informative që të theksohet rritja e popullaritetit të Kapitalit të Marksit me shpallimin shokant të krizës globale financiare gjatë muajve të fundit. Në anën tjetër, disa nga e majta tashmë kanë filluar të shpallin triumfalisht fundit e projektit neoliberal dhe ardhjen e një epoke të re ku, sipas këtyre, do të shohim... [faqe 7](#)



KOSOVA MBETET PA EKONOMI

Derisa në dhjetëvjetëshin 1989 - 1999 Serbia ia plaçkiti pronën Kosovës dhe ia shkatërroi ekonominë, në dhjetëvjetëshin 1999 - 2009 këtë e vazhduan disa tanët bashkë me ndërkombëtarë. Derisa në dhjetëvjetëshin e parë ekonominë na e shkatërroi armiku ynë, në këtë dhjetëvjetëshin e dytë vetë njerëzit tanë, shqiptarët, na plaçkitën. Përderisa ne ankoheshim me për-buzje se indianët e afrikanët nuk mund të na e mësojnë demokracinë neve, ne po zhvateshim nga perëndimorët. Prej ardhjes së misioneve ndërkombëtare në Kosovë, UNMIK-ut dhe KFOR-it, ato gjithnjë janë udhëhequr nga "perëndimorët". I pari i UNMIK-ut gjithmonë ka qenë evropian ndërsa zëvendësi i tij (udhëheqësi i vërtetë i misionit) ka qenë amerikan. Këshilltarët e tyre, zëdhënësit, personat në pozicione të rëndësishme vendim-marrëse si p.sh. udhëheqësi i Zyrës Ligjore në UNMIK, të gjithë kanë qenë evropianë apo amerikanë. Në sistemin e drejtësisë

prokurorët dhe gjykatësit pothuajse pa përjashtim kanë qenë evropianë dhe amerikanë. Aziatikët kanë qenë këtu vetëm argat si p.sh. për të na dhënë dajak (kujtojini forcat speciale pakistaneze që një kohë na shfaqeshin përditë në televizion për të na frikësuar). Historia jonë dhjetëvjeçare me çlirimtarë gjithfarë sojesh, vendorë e ndërkombëtarë, me warlords e kauboje, është histori e pasurimit të një rrethi të ngushtë njerëzish dhe varfërimit të shumicës së popullit të Kosovës. Si për rastësi, sot njerëzit më të pasur në Kosovë janë kryetarët e partive politike që në kohë të ndryshme kanë qenë kryeministra të Kosovës, të pasuar nga vëllezër e familjarë të tyre, pas-taj ministrat (poashtu me familjarë) dhe në fund këshilltarët e tyre të cilëve iu hidhet nga një copë asht për ta lëpirë. Nga kjo deduktohet me lehtësi se pushteti dhe pasurimi në Kosovë janë të lidhura ngushtë, në fakt janë e njëjta gjë. Kjo shpjegon edhe luftën e ashpër për

pushtet mes partive politike të Kosovës. Në anën tjetër, të gjithë i dimë statistikisht e Bankës Botërore që flasin për më shumë se gjysmën e popullatës së Kosovës që jeton në varfëri absolute me më pak se dy dollarë në ditë. Por kjo është një statistikë zyrtare e zbutur sepse varfëria në Kosovë është shumë më e madhe. P.sh. sa janë të pasur ata që janë mbi këtë minimum të varfërisë, ta zëmë ata që jetojnë me tre dollarë në ditë? Apo ata që jetojnë me pesë dollarë në ditë? Nëse varfërinë në Kosovë nuk e masim teknikisht por me nevojat njerëzore për një jetë normale me dinjitet atëherë shumë lehtë mund të përfundojmë se varfëria këtu është shumë mbi 50%-in. Për këto dhjetë vite të pas-luftës në Kosovë kishte një yrysh të madh për të shitur tërë pronën shoqërore të Kosovës, ndërmarrjet shoqërore, fabrikat, depot, tokat bujqësore, kioskat, etj. Çdo gjë që mund të shitej duhej të shitej.

editorial

(vazhdon në faqen 2)

Një qasje tjetër për zhvillimin e energjetikës në Kosovë

Avni KURSHUMLIU

Duke qenë njëri ndër ekspertët më të vjetër për nga stazhi i pandërprerë në lëminë e energjetikës, duke parë gjendjen e vështirë sidomos pas luftës, i jam qas dhënies së kontributit përmes shkrimeve në revista e gazeta ditore, seminare si dhe emisione televizive. Idetë e mia për zhvillimin e energjetikës në Kosovë bazohen në resurset e mëdha të rezervave të thëngjillit që posedon Kosova, nevojën permanente për furnizim të rregullt të konsumatorëve dhe industrisë me energji, në njërin anë dhe në anën tjetër gjendja e objekteve ekzistuese energjetike të cilat për momentin janë në eksploitim nga ana e KEK-ut. Por, kuptohet, vazhdimisht duke vënë në rend të parë mbrojtjen e ambientit.

Gjatë ndërtimit të TC Kosova B1 e 2, paralelisht ka qenë bërë projekti për ndërtimin e TC Kosova B 3,4,5 me ngarkesë secila nga 600 MWh e që në atë kohë quhej projekti i TC Kosova e madhe. Kuptohet ndërtimi ka qenë paraparë në faza sipas nevojës për energji. Në të njëjtën kohë zhvillohej ideja për një TC 2400 MWh, që atëherë quhej TC Kosova C e që duhej të ndërtohej diku ne Lapna selo ne drejtim të Ferizajt. Kosova C ishte planifikuar si një objekt që duhej të ndërtohej nga investimet e huaja dhe me tërë prodhimin duhej të dispononin investitorët. Të gjitha këto kanë qenë projekte të ish-federatës Jugosllave ku më së paku merrej parasysh interesi i popullsisë së Kosovës. Pas aktivizimit të blloqeve Kosova B1 e B2 (viti 1984), veç sa kishte filluar kriza politike dhe ekonomike në ish-Jugosllavi, kështu që këto projekte kurrë nuk e kanë marrë ngjyrën e gjelbër për fillim të realizimit.

Pas luftës me ardhjen e UNMIK-ut çështja e energjetikës në Kosovë ishte ekskluzivitet i Shtyllës së Katërt ku nga ana e kosovarëve kryesisht kanë qenë të angazhuar përkthyesit e anglishtes. Në AER ku për energjetikë gjithashtu kanë qenë të angazhuar "ekspertë" të huaj, siguroheshin donacione dhe bëheshin plane për investime në energjetikë të cilat kryesisht përkufizoheshin në mirëmbajtjen e objekteve ekzistuese apo blerje të energjisë elektrike por pa ndonjë

strategji të mirëfilltë të zhvillimit. Në kompetencë të këtyre ka qenë angazhimi i "ekspertëve" kryesisht të huaj të cilët udhëhiqnin me KEK-un pa treguar asnjë interes që kjo korporatë të ketë perspektivë zhvillimi.

E konsideroj sidomos të dëmshëm për KEK-un angazhimin e firmës Swed Power (prej vitit 2001) të cilët ishin të angazhuar si firmë këshilluese por në të vërtetë plotësisht udhëhiqnin me KEK-un. Pasoja negative të riorganizimit që ata realizuan në KEK as sot e gjithë ditën nuk po mund të eliminohen. Ata ishin apriori kundër idesë për zhvillimin e kapaciteteve të reja vetanake në energjetikë. Në këtë pikëpamje sidomos ka qenë e ashpër një koordinatore dhe zëdhënëse e firmës Swed Power (zonja Bety Dewidson) e cila me shkrim na ndalonte (kuadrore vendore) që të komunikojmë me

“ Prandaj mendoj se menjëherë duhet një qasje serioze për ndërtimin e TC B3-shit, kuptohet në bashkëpunim me Shqipërinë. Bashkëpunimi i mirë viteve të fundit me KESH-in dëshmon se ky bashkëpunim duhet të thellohet akoma më tepër. Largpërçuesi 400 KV mundëson edhe integrimin e këtyre dy korporatave. Duke parë interesin e integrameve rajonale mendoj se me prioritet duhet t'i qasemi integrameve brenda kombëtare. Kjo do të ishte me interes të madh ekonomik për të dy vendet.”

gazetar. Së pari idenë për ndërtimin e B3-shit dhe si alternativë më e shpejtë për zbutjen e problemeve me furnizim me energji, ndërtimin e një termocentrali me gaz në afërsi të Hanit të Elezit, e kam paraqit në një këshillim për energjetikën që është mbajtur në shtator të 2001 në sallën e KEK-ut. Meqë këtë këshillim e udhëhiqte zonja Bety Dewidson (koordinatore e firmës Swed Power) është refuzuar ashpër nga ana e saj. Të njëjtin propozim, disa dite më vonë, ia kam paraqitur edhe Presidentit të ndjerë Rugova por ai më është përgjigjur se për momentin nuk mund të bëjmë asgjë për shkak se energjetika është kompetencë e shtyllës së katërt. Në kuadër të fushatës parazgjedhore për zgjedhjet lokale në vitin 2001 në duelet televizive në RTK dhe KTV gjithashtu i kam paraqitur këto ide. Atëherë kam theksuar se ka rëndësi kapitale ndërtimi i largpërçuesit 400 KV që do të lidhte Kosovën me Shqipërinë. Atëherë, por edhe sot, po të ekzistonte ky largpërçues as Kosova dhe as Shqipëria nuk do të ndjenin mungesën e energjisë elektrike. Gjatë natës në Kosovë paraqiten teprica të mëdha të energjisë (për shkak të zvogëlimit të konsumit) kjo do të

këmbehej me Shqipërinë dhe në atë kohë atje do të kursehej uji ne HE. Në situatën e tanishme me largpërçuesin e 220 KV kjo vështirë mund të realizohet nga ana e Kosovës, për shkak të diferencës së tensionit në vendin e kyçjes.

Dhënien e kontratës për menaxhim të KEK-ut firmës ESBI nga Irlanda e konsideroj të dëmshme për KEK-un pasi që rezultatet e punës së tyre kanë qenë tejet negative. Ata as që kanë dashur të bisedojnë për zhvillimin e KEK-ut por me çdo kusht kanë dashur të argumentojnë se këtu kinse nuk ka kuadro që do të mund të udhëheqin me KEK-un. Gjer me ardhjen e ESBI-së, në KEK ka funksionuar ekipi i zhvillimit, ekip të cilin ata e shkatërruan menjëherë. Dhe sot KEK-u është një korporatë që nuk ka ekip për zhvillim. E gjithë kjo shton dyshimin se më herët është përgatitur strategjia që Kosova të mos ketë objekte energjetike. Pas luftës "ekspertët e jashtëm disa herë kanë theksuar se TC Kosova A duhet të mbyllet për shkak të vjetërsisë por pa propozuar ndonjë alternativë për kompensimin e këtij prodhimi.

Disa herë radhazi me shkrime në të përditshmet e ndryshme kam kundërshtuar idenë për ndërtimin e Kosovës C (tani Kosova e re), të cilën edhe tani e konsideroj si një projekt megaloman. Duke u bazuar edhe në një mori konsultimesh që janë ndërmarrë lidhur me këtë projekt është i bazuar dyshimi se rreth

këtij projekti ka shumë gjëra që nuk janë të qarta. Duke u nisur nga pronari apo bashkëpronarët, pjesëmarrja e Kosovës, mbrojtja e ambientit, furnizimi me ujë, rjeti shpërndarës, marrëdhëniet me KEK-un, perspektiva e KEK-ut, tregu i energjisë, lokacioni i ndërtimit etj. Të gjitha këto kërkojnë definime të sakta para se të fillohet me realizimin e këtij projekti. Në bazë të kësaj mund të konkludohet se as qeveria e kaluar nuk ka qenë fare më afër realizimit të këtij projekti. Strategjia e bazuar vetëm në investime të huaja nuk garanton edhe zgjidhje të problemit të furnizimit të konsumatorëve me energji. Thjesht, ajo energji e prodhuar në Kosovë do t'i ofrohet tregut të lirë e dihen principet e këtij tregu – ai që paguan më mirë edhe do ta ketë. Aq më e keqe është ideja e mbylljes së menjëhershme të TC A. Tani këtë nuk e bëjnë as vendet më të pasura me resurse energjetike por i kanë hyrë seriozisht revitalizimit të objekteve të vjetra. Për shkak të monopolit me energji e konsideroj të rrezikshme idenë që investitorit të

ishite premtuar. Në vend të zhvillimit ekonomik ne vetëm sa u shpronësua dhe sot, për shkak se nuk jemi më pronarë të këtyre ndërmarrjeve shoqërore, jemi në situatën e pengut ku për mbijetesën tonë, për humbjen apo ruajtjen e vendit tonë të punës vendos një grup i vogël njerëzish në qeveri dhe biznese. Tash të njëjtit njerëz (si Ahmet Shala bashkë me konsulentët e tij nga USAID-i), në të njëjtën mënyrë, me të njëjtat procedura që i shitën ndërmarrjet shoqërore duan t'i shesin edhe ndërmarrjet publike, KEK-un, PTK-në, Aeroportin dhe Trepçën. Të njëjtit, nuk duan vetëm ta ndërtojnë Kosovën C, por duan që kompanisë fituese t'ia falin qymyrimin e të gjitha asetet e KEK-ut duke na bërë neve blerës të qymyrit tonë. Politikanët e korruptuar të Kosovës (të cilët motivohen vetëm nga maksimizimi i përfitimeve të tyre personale) po inkurajohen nga ekipet e "ekspertëve" ndërkombtarë (të cilët motivohen nga interesa të kompanive të vendeve prej nga vijnë) që të shesin tërë pasurinë e mbetur të Kosovës. Këto kompani publike

"Kosovës së Re" t'i jipet me koncesion edhe revitalizimi i TC A dhe TC B.

Është e pakuptimtë që pas 47 vjetëve traditë në prodhimin e energjisë nga linjtë ne të pajtohemi se tani e tutje nuk do të prodhojmë më por këtë do e bëjmë për një prodhues të huaj.

Unë mendoj se propozimi i Qeverisë së Shqipërisë që në Kosovë të ndërtohet një TC me investime të përbashkëta është dashur të përkrahet pa rezervë aq më tepër kur u ofruan 300 milion euro për fillimin e menjëhershëm të punëve. Ky kishte me qenë blloku Kosova B3 prej 600 MWh. Ky bllok i kombinuar me blloket tjera të KEK-ut dhe të KESH-it do të mjaftonte që dy vendet t'i plotësojnë kërkesat për energji. Për TC Kosova B3 ekzistojnë studimet e fizibilitetit si dhe projektet e ndërtimit. Përparësi tjera të mëdha në favor të B3-shit kishin me qenë infrastruktura e gatshme nga B1 e B2, deponia dhe transporti i thëngjillit, përgatitja kimike e ujit (me një zgjerim të vogël) si dhe asetet tjera të KEK-ut. Si i tillë ndërtimi i këtij objekti nuk do të kushtonte më shtrenjtë se 600 milion euro që për pjesën e KEK-ut kjo do të ishte më pak se vlera e borxhit të konsumatorëve.

Projekti TC Kosova B3 duhet të parashohet të gjitha zgjidhjet më moderne për një punë të pastër për sa i përket ekologjisë. Me këtë rast do të eliminohej paniku që është prezent te popullata përreth nga mundësia e katastrofës ekologjike që do të shkaktonte ndërtimi i menjëhershëm i TC Kosova e Re me 2100 MWh.

Meqenëse në TC Kosova B1 e B2 janë aplikuar zgjidhjet më moderne për udhëheqjen e blloqeve, përgatitja e kuadrit manipulues për mirëmbajtje të TC B3 nuk do të paraqiste problem. Më vonë në bazë të nevojës dhe kuotës së lejuar për emetim të CO2 – shit mund të vazhdohet suksesivisht me TC B4 e me radhë. Vazhdimi i mëtutjeshëm i diskutimeve për TC Kosova C apo e Re që po zgjasin me vite të tëra paraqet humbje të kohës që në energjetikë nuk mund të kompensohet. Prandaj mendoj se menjëherë duhet një qasje serioze për ndërtimin e TC B3-shit, kuptohet në bashkëpunim me Shqipërinë. Bashkëpunimi i mirë viteve të fundit me KESH-in dëshmon se ky bashkëpunim duhet të thellohet akoma më tepër. Largpërçuesi 400 KV mundëson edhe integrimin e këtyre dy korporatave. Duke parë interesin e integrameve rajonale mendoj se me prioritet duhet t'i qasemi integrameve brenda kombëtare. Kjo do të ishte me interes të madh ekonomik për të dy vendet. Me këtë rast përveç sigurimit të energjisë së mjaftueshme kjo do të mundësojë që KEK-u të lirohet nga pagesa shtesë (te cilën ia bëjmë Serbisë) për rregullimin e frekuencës, sepse me HC e KESH-it kjo do realizohej edhe më lehtë.

Vazhdon nga ballina

KOSOVA MBETET PA EKONOMI

Kjo bëhej me një plan të caktuar dhe quhej privatizim. Për të zbatuar planin e privatizimit ishin dizajnuar institucione të veçanta, Shtylla e katërt e UNMIK-ut që udhëhiqej nga Bashkimi Evropian dhe nën-institucioni i saj Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM). Privatizimi bëhej në emër të zhvillimit ekonomik të Kosovës; në emër të "dekomunizimit" të saj, të kalimit nga ekonomia e centralizuar në ekonomi të tregut të lirë. Privatizimi na u shit si mënyrë për uljen e papunësisë dhe zbutjen e varfërisë. Por edhe si mënyrë e integritimit me botën perëndimore aq të lakmuar nga ne. Por ç'i solli privatizimi Kosovës? Paratë e privatizimit që janë para të punës sonë dyzet e ca vjeçare na u morën dhe u dërguan në banka jashtë Kosovës, sepse Serbia pretendon hise mbi to. Punëtorëve të Kosovës u mohohet 20%-shi i punësuar nga

shitja e ndërmarrjeve ku ata kanë punuar. Shumica e këtyre punëtorëve sot janë të papunë, jetojnë në familje shumë anëtarëshe në varfëri ekstreme. Nidhmat sociale edhe kur ekzistojnë keqpërdoren, shpërndahen me favore. Hapësirat e fabrikave ku dikur prodhohej sot janë kthyer në depo mallrash, ndërsa tokat bujqësore që janë shitur me centë janë kthyer në troje ndërtimi. Ndërmarrjet e shitura sipas të ashtuquajturit "spin-off special" ku blerësi obligohej të investonte shumta të caktuara dhe të punësonte numër të caktuar punëtorësh për një periudhë kohore, dështuan në masë të madhe në përmbushjen e obligimeve të tyre. Edhe ndërmarrjet e mëdha si "Ferronikeli" që kishin tregun e garantuar nuk i përmbushën ato obligime duke mos u sjellur qytetarëve të Kosovës kurrfarë përfitimi. Privatizimi doli të jetë e kundërta e asaj që

janë baza mbi të cilën mund të zhvillohet ekonomia në Kosovë. Posta e telekomi, aeroporti dhe energjia mund të sjellin një zhvillim të fuqishëm ekonomik nëse mbahehen në pronësi të vendit, e sidomos nëse menaxhimi i tyre nuk e ka për qëllim shkatërrimin por zhvillimin e tyre ekonomik. Me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe tash me privatizimin e paraparë të kompanive publike Kosova rrezikon të mbetet pa ekonomi. Me shitjen e tërë pronës publike, qytetarët e Kosovës do të jenë të papronë në vendin e tyre. Me marrëveshjet e tregtisë së lirë si CEFTA ne e kemi hapur tregun tonë për prodhuesit e jashtëm duke e pamundësuar kështu zhvillimin e prodhimit vendor. Bujqësia përveç që nuk mund të zhvillohet për shkak të këtyre marrëveshjeve, edhe ndihmat që i merr prej qeverisë janë të papërfillshme. Me këso ideologjie që njeriun ia nënshtron tregut, që çdo gjë ka një çmim, Kosova s' do të ketë ekonomi fare. Dhe pa ekonomi nuk mund të ketë shtet!

Kosova e Re (C)

Ku është interesi kombëtar në këtë projekt?

Luan SHLLAKU

Ndërtimi i termocentralit Kosova C, është padyshim projekti më i madh kosovar, me të cilin synohet të ngritët dukshëm potenciali ynë ekonomik në të ardhmen. Po ashtu, Kosova C do të duhej në të njëjtën kohë ta eliminonte krizën më të madhe zhvillimore të pas luftës - krizën energjetike. Ky projekt tashmë pothuaj 8 vjet është në tërësi në fazën e punës. Janë bërë shumë studime, të cilat kanë sjellë shumë njohuri të reja për aspekte të ndryshme, që këtë investim, e bëjnë të jetë aq shumë të dëshiruar dhe në të njëjtën kohë edhe të urryer në një pjesë të popullatës.

Nuk ka dyshim se projekti Kosova C do ta avancojë pozitën e përgjithshme të ekonomisë kosovare, dhe posaçërisht energjetikës. Deri më sot furnizimi i pamjaftueshëm me energji elektrike e ka krijuar një grykë të ngushtë në proceset zhvillimore në vend. Është menduar se, me potencialin minerar që Kosova ka sot, dhe me ndihmën e pakursyer financiare të donatorëve të jashtëm, të cilët shpenzuan në këtë sektor më shumë se 1 miliardë euro, pas luftës, do të jetë fare e lehtë të zgjidhet ky problem. Mirëpo, edhe 10 vjet krizë energjetike, e cila seriozisht e ka rrezikuar zhvillimin e vendit në këtë periudhë, ishin të pamjaftueshme për të gjetur zgjidhje.

Pa u futur në histori të këtij problemi, sot shihen qartë 3 momente shqetësuese për perspektivën e këtij projekti: (1) Skenarët e ndërtimit të këtij TC, të ofruar deri tash, sjellin shumë konflikte, në radhë të parë mjedisore, sociale, demografike, si dhe konflikte makroekonomike në trekëndëshin energjetike - bujqësi - ekonomi ujore. (2) Skenarët e prezantuar dhe të përfolur (akoma ka shumë fshehtësi në veprime të atyre që "kujdesen" për këtë projekt), rrezikojnë të krijojnë monopol të një kompanie të jashtme, që s'do t'i sjellë asgjë të mirë dhe me leverdi ekonomisë kosovare, dhe (3) interesi madhorë, kombëtarë i këtij projekti, që Kosova të del me përfitime sa më të mëdha, mund të zbehet dukshëm nga skenarët që propozohen nga agjencitë që e ndihmojnë realizimin e këtij projekti: BB, USAID dhe një pjesë e qeverisë kosovare, që nuk është duke i parë këto rreziqe.

Le t'i elaborojmë këto tri rreziqe më mirë!

E para: Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis dhe Social është një dokument që Forumi 2015 kërkoi të bëhet para se të merret vendimi për Kosovën e Re, në prill 2007. Banka Botërore u pajtua me këtë vërejtje dhe kërkesë, dhe e zgjodhi ekipin e jashtëm, një kompani italiane, që të punojë në hartimin e këtij dokumenti shumë të rëndësishëm. Ky dokument, u prezantua në pranverë të 2008-tës, dhe, edhe pse nuk ishte i ndonjë cilësie të duhur, solli konkluzione të qarta për sa i përket cilësisë së mjedisit, para dhe pas ndërtimit të Kosovës e Re, situatës me ujëra etj. Çka thuhet në këtë raport, dhe si duhet kuptuar ai? Në konkluzione të këtij raporti thuhet të gjitha ato që ne i thamë më parë: "se mjedisi aktual është i prekur thellë nga aktivitetet minerare"; "se cilësia e ajrit është shumë e dobët për shkak të emetimeve nga Kosova A dhe B"; "se furnizimi me ujë është potencialisht faktor kufizues për zhvillimin e projektit"; "se cilësia e tokës dhe ujërave ka pësuar shumë nga depozitimi i hirit dhe mbetur-

naive"; etj. Kështu, shprehimisht shkruan në konkluzat e Vlerësimit. Çfarë përfundimi duhet marrë pas këtyre konkluzave të argumentuara me shumë të dhëna që përbën ky studim?

Nëse i lexoni drejtë konkluzionet e këtij studimi, do të shihni qartë se nuk ka hapësirë për të qenë komod me ndërtimin e kapaciteteve të mëdha, prej 2100 MW, në Kastriot, sepse niveli i ndotjes dhe zërja e tokave është shumë e lartë, dhe çdo kapacitet i ri do ta përkeqësojë dukshëm gjendjen. Por, duke u nisur nga nevoja e madhe që kemi për energji elektrike, duhet patjetër të marrim një vendim kompromisi, për një "Kosova e Re" që do të kishte sjellë mjaftë energji, përfitime meritorë për ekonominë kosovare, dhe ndotje që mund të përballohet më lehtë.



E dyta: ndërtimi i Kosovës e Re, është një ndërmarrje shumë komplekse, sigurisht projekti më i madh dhe më i ndërlikuar që Kosova mund ta ketë jo vetëm në këtë moment por edhe në shumë dekada të ardhshme. Dhe këtu nuk jam duke e adresuar kompleksitetin tekniko-teknologjik, apo demografik dhe social, ose edhe atë të konflikteve makroekonomike që ky projekt sjell, por e kam fjalën për marrjen e vendimeve meritorë, pra vendimeve më të qëlluara që Kosovës do t'i sjellin maksimumin e përfitimeve financiare dhe minimumin e mundshëm të ndikimeve negative, të përmendura më lartë. Thjeshtë, jemi në fazën më të rëndësishme, dhe më të ndjeshme në të njëjtin moment - fazën kur qeveria e Kosovës do të duhet të vendos se cili është Skenari i ndërtimit të kësaj termocentrale, dhe çka na sjell ai skenar. Një luftë e ashpër tashmë ka filluar në mes të atyre që përfaqësojnë interesat e ndryshme, në këtë projekt. Mendimet janë të ndara, kemi opsione shumë "kosovare" që lufojnë për skenarin më të favorshëm për Kosovën, dhe këtu shoh shumë organizata dhe individë të shoqërisë civile, por e shoh edhe

“ Të luftosh sot për interesin kombëtar të Kosovës në projektin Kosova e Re, do të thotë të luftosh për t'i siguruar asaj dhjetëra miliardë euro, të cilat shumë lehtë mund të shndërrohen në pazare me disa zero më pak, për ne.”

një pjesë të vogël të qeverisë duke luftuar për këto interesa. Në anën tjetër shoh shumë qeveritarë të tjerë, me dhe pa shumë kompetenca të përzihen në këtë projekt, por shoh edhe agjenci të jashtme të cilat, çuditërisht, pasi që ndihmuan shumë dhe investuan po ashtu shumë edhe në zhvillimin e këtij projekti, mendojnë se duhet vetëm Ata të vendosin edhe për skenarin/modalitetet e ndërtimit: se kush, si, kur dhe sa do të investojë

Sibofcit, dhe bashkëpronësi të rëndësishme, në TC Kosova e Re, atëherë mund ta quajmë skenarë të dështuar për Kosovën, cilëndo ndarje tjetër të pronësisë, sepse siç mund të argumentohet lehtë, Kosova nuk do të përfitonte asgjë nga ky investim "shekullorë" me të cilin aq shumë mburreshin të gjitha partitë që ishin në qeveri deri tash. Mirëpo është kjo qeveri që i takoi përfundimisht ta realizojë këtë investim, në të mirë të qytetarëve të saj, dhe është kjo qeveri ajo që duhet të mendohet mirë para se ta "pres" pazarin. Sepse pazarin ka filluar të bëhet paksa i ndryshëm, tipik për "aksham pazaret" ku shitësi dhe blerësi mundohen që në terr të përfitojnë nga ngutja e njërit (kosovarëve në këtë rast që mezi presin të dalin në dritë) dhe interesave të tjetrit (nuk dua t'iu jap emër, sepse janë më shumë se një), të cilët duan të përfitojnë nga fakti se jemi në terr dhe duhet bërë shpejt pazar - kur ne s'po na pritët ma, dhe kur çmimi është shumë i ulët (lexo: përfitimet tona nga ky investim).

Lufta për Sibofcin tashmë ka filluar - vrojtuesit e kujdesshëm mund të shohin shumë lëvizje në këtë drejtim të palëve që mbajnë pozicione të ndryshme, ose më mirë të themi të palëve që kanë interesa të ndryshme. Kush e fiton Sibofcin, e fitoi luftën. E luftën e ka fituar ai që do t'ia arrijë të mbajë sa më shumë pronësi mbi Sibofcin dhe mbi TC Kosovën e Re. USAID dhe BB thonë se luftën duhet ta fitojë investitori i jashtëm, të cilit duhet dhënë të gjitha: Sibofcin dhe Kosovën e Re, sepse "ne nuk jemi në gjendje t'i menaxhojmë si duhet këto njësi", dhe se "ne nuk kemi mjete financiare për t'u përballë me këtë". Disa qeveritarë tanë mendojnë

në këtë projekt, dhe se cili do të jetë përfitimi ynë nga ky investim madhor! Me gjithë respektin që duhet ta kemi për këto organizata të fuqishme, do të duhej që në këtë moment jetik për ne, të shkëputemi nga tutelet e tyre, dhe të vendosim Vetë se çka duam dhe si e duam këtë investim. Është investim i cili më shumë do t'i afektojë fëmijët tanë se sa ne, që tashmë jemi mësuar të jetojmë me pak, me shumë pak bile, ama, kjo nuk është ajo që do të dëshironim ta ndërtojmë për fëmijët tanë.

E treta: të luftohet për një pozicion sa më të fortë dhe strategjik, në ndarjen e ardhshme të pronësisë mbi minierën e Sibofcit, termocentralet Kosova A, B dhe Kosova e Re, me investuesin e jashtëm privat (njëra nga 4 kompanitë e përzgjedhura), është në të vërtetë e tëra që duhet bërë nga ana e qeverisë sonë në këto momente vendimtare. Pra, qeveria do të duhej të mbajë pronësi maksimale, brenda skenarëve të mundshme dhe logjike, mbi minierën e Sibofcit, si pozicion strategjik i rëndësishëm për zhvillimet e mundshme më vonë, si dhe mbi termocentralet, sidomos ate Kosova e Re. Nëse ne nuk mbajmë pronësi dominante mbi minierën e

ndryshe: ata thonë se ne pa problem do të mund të mbanim pronësi mbi minierën e Sibofcit, si dhe ta menaxhojmë plotësisht apo pjesërisht. Poashtu ata thonë se ne mund dhe duhet të jemi bashkëpronarë edhe të TC Kosovës e Re, deri në një përqindje të lartë. Ama, jo 100% të kalohet në duar të investitorit privat të jashtëm, si na thuhet, na sugjerohet dhe, besa, edhe na urdhërohet nga pak. Diferenca në mes të këtyre dy opsioneve është dhjetëa miliardë euro, që do të shkonin në llogari të investitorit të jashtëm apo në llogari të Kosovës. Është fjala për 40 vjet pune të termocentraleve që do të ndërtohen dhe minierës së Sibofcit që do t'i shter ato 1 miliard tonë linjit që mban në vete, të cilat, kur marrim parasysh mungesën e energjisë me të cilën ballafaqohet sot e tërë Europa, dhe posaçërisht Ballkani, e bëjnë këtë biznes shumë profitabil.

Të luftosh sot për interesin kombëtar të Kosovës në projektin Kosova e Re, do të thotë të luftosh për t'i siguruar asaj dhjetëra miliardë euro, të cilat shumë lehtë mund të shndërrohen në pazare me disa zero më pak, për ne.

Një skenar i zi për PTK-në që rrezikon të aplikohet për kompanitë tjera publike

Avni ZOGIANI

Ekziston një alibi gjeneral për privatizimin e kompanive me pronësi publike që përdoret nga institucione të rëndësishme ndërkombëtare: privatizimi duhet të ndodhë për shkak se kompanitë me status publik kanë probleme, nuk performojnë mirë. Mirëpo nëse shifet procesi në praktikë, ajo që ndodhë zakonisht është se gjëja e parë që ndodhë është vendosja e një keq-qeverisjeje në këto kompani nga qeveritë vendore. Zakonisht kjo mënyrë e sjelljes së qeverive vendore përkrahet nga këto institucione ndërkombëtare me qëllimin që të krijohet alibi për privatizimin. Kështu që keqmenaxhimi ndodhë për të krijuar alibi për privatizim e jo privatizimi për ta shpëtuar kompaninë nga keqmenaxhimi. Një shembull tipik i kësaj logjike është Postë Telekom i Kosovës (PTK).

Në një intervistë për RTV21 ministri i ekonomisë dhe financave, duke folur për privatizimin e PTK-së, tha se "nuk do të ketë më privatizime sikur ato që janë bërë më përpara". Kjo do të thotë se ai hodhi poshtë me gojë të tij tërë procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore që u bë brenda këtyre dhjetë viteve. Natyrisht ministri Shala nuk është i pari që konstaton një proces si të dështuar. Natyrisht ky deklarim i ministrit Shala nuk na mëson asgjë të re. Ky proces u cilësua dhe u provua i tillë nga kushdo që u mor me të, përfshirë këtu edhe institute ekonomike të afërta me qeverinë. Mirëpo, rëndësia e këtij deklarimi të zotit Shala qëndron në faktin se ky konstatim i bërë nga vetë ai shpall si të dështuar punën e tij në AKM për vite me radhë dhe i hap atij rrugë për të vazhduar të njëjtën gjë me kompanitë publike. Natyrisht, nuk mund të thuhet se ai ka tërë përgjegjësinë për atë që ndodhi në AKM, por ai nuk është dëgjuar ndonjëherë të thotë qoftë edhe një fjalë të vetme skepticizmi për këtë proces për vite me radhë dhe tani e shpall të dështuar kur gjithcka ka mbaruar. Do ta durojmë zotin Shala edhe për një fazë tjetër privatizimi në mënyrë që në fund të pesë-gjashtë viteve të na dali prapë me një reflektim se nuk do ta përsërisë më gabimin? Me fjalë tjera do t'ia japim atij edhe këta disa miliarda vlerë publike që t'i bëjë rrush e kumbulla dhe në fund të procesit të thotë, upss më falni, prapë gabova?

Ministri Shala është në krye të Komitetit për privatizimin e PTK-së, kompanisë kosovare me vlerën më të lartë në të dy sektorët, edhe në atë publik edhe në atë privat. Ai pra do të udhëheq një proces privatizimi, kësaj radhe të kompanive publike, edhe pse vetë e pranon se një proces tjetër



privatizimi që i priu, ai i ndërmarrjeve shoqërore, e ka dështuar për vite me radhë. Ky është një ogur i keq për privatizimin e kompanive publike në Kosovë, shtyllave të fundit të ekonomisë dhe shpresës së fundit për t'i thyer dyert e hekurta të varfërisë që Kosovën

tërësisht i kapur nga konkurrenca dhe politika, Anton Berisha, i cili politikat e derisotshme i nxori në disfavor të kompanisë publike.

Një marrëveshje që u lidh në emër të PTK-së për operimin virtual të thirrjeve telefonike, e që u

së në një konzorcium shumë të dyshimt në operatorin e katërt të telefonisë mobile në Shqipëri. Kjo paradoksalisht mund ta fusë në konzorcium një kompani publike të Kosovës me një biznesmen shqiptar të njohur si afarist të afërt me multimilionerin serb dhe ish-ministrin në njërin nga qeveritë në kohën e Millosheviqit, Milorad Mishkoviqin. Veprim tjetër që mund të jetë goditje finale ndaj PTK-së është angazhimi i drejtorit aktual Shyqyri Haxhaj për të bërë PTK-në themeluese të një banke, gjë që mendohet të bëhet nëpërmjet blerjes së borxheve të Bankës (së bankrotuar) kreditore, drejtorin e së cilës Haxhaj e solli dhe e emëroi drejtor financiar të PTK-së. Në të njëjtën kohë drejtori aktual në bashkëpunim me bordin tërësisht politik filloi një fushatë punësimi të mbi 100 punëtorëve, në mesin e të cilëve një numër i konsiderueshëm i aktivistëve të PDK-së, gjegjësisht ish-pjestar të SHIK-ut.

Natyrisht, të tëra këto i kushtuan PTK-së dhe në fillim të këtij viti u konstatua një rënie e të hyrave për rreth 30% për çka menaxhmenti aktual u mundua ta fajësonte krizën ekonomike ndërkombëtare edhe pse periudha për të cilën flitej nuk përfshiente krizën ekonomike.

Ky është skenari që u përcoll nga qeveria aktuale në raport me PTK-në. Natyrisht, kjo nuk mund të quhet ndryshe vetëm se një shkatërrim i qëllimshëm i një prone publike. Mirëpo, këtu lind pyetja pse bëhet kjo? Ekziston një shpjegim universal që zbatohet

në këto raste që si vepër sanksionohet konflikt interesi e që nënkupton përfaqësimin e intereseve tjera nga ato publike e të përgjithshme nga ana e zyrtarëve publik, që në shumicën e rasteve shfaqet si përfaqësim i intereseve private në zyrën publike.

Një numër i konsiderueshëm i zyrtarëve e menaxherëve në sektorin publik përfaqësojnë interesa të konkurrencës derisa mbajnë zyra vendim-marrëse në sektorin e kompanive publike. Në rastin e PTK-së ky konflikt interesi u vendos qysh në kohën e tenderit për operatorin e dytë të telefonisë mobile kur pjesa substanciale e liderëve politik e mbrojtë këtë tender edhe pse në fundamente ishte i paligjshëm dhe ishte organizuar nga një autoritet gjysëm-ligjor si ART-ja. Ky konflikt interesi është thelluar më tutje me emërimin e Dino Asanajt në Bordin e AKM-së, pozicion ky që i krijonte atij mundësinë për të vendosur në emër të operatorit publik të telefonisë mobile në ndërkohë që kishte aksione në operatorin privat të telefonisë mobile.

Kjo që ka ndodhë në PTK është një dukuri që po ndjeket në një numër të konsiderueshëm të kompanive publike. Që nga bartja e kompetencave tek qeveria kosovare Korporata Energjetike e Kosovës është udhëhequr nga njerëz që haptazi kanë deklaruar qëllimin e tyre për ta mbyllur këtë kompani për të lëshuar rrugë për kompani private të huaja.

Rasti skandaloz i (Vazhdon në faqe 5)

“ Aktualisht Kosova është në prag të vendimeve në ekonomi që do të kenë pasoja ose rezultate për dekada me radhë. Nëse në krye të këtyre proceseve vendosen njerëz të paafët dhe të paintegritet, Kosova rrezikon të shndërrohet në një vend që do t'i ngjajë shumë një kolonie që nuk ka kufizime në eksploitim. Kjo nuk mund të lejohet të ndodhë në emër të kurrfarë ideali a miqësie duke qenë se nëse vazhdojnë këto praktika Kosova rrezikon të ngelet një vend pa ekonomi.”

po e çon drejt urisë.

Mirëpo, a qëndron problemi vetëm tek ministri Shala? Që nga vendosja e kësaj qeverie, kompania më fitimprurëse publike, PTK, ashtu si edhe Aeroporti i Prishtinës dhe KEK-u, është vënë nën thikat e shumë akterëve vendor e sidomos ndërkombëtar. Fillimisht ministri i Transportit dhe Telekomunikimit Fatmir Limaj bëri një presion ndaj menaxhmentit të kësaj kompanie me kërcënim për uljen e pagave duke bërë që një numër profesionistësh të kalojnë në kompaninë konkurrense private, e cila kishte kohë që kishte vendosur ndikim mbi politikën. Edhe gjatë kësaj qeverie, si në atë paraprakën, PTK, gjegjësisht Vala 900, u la nën mëshirën e një rregullatori (ART) të udhëhequr nga njeriu

shpërblye në rrethana krejtësisht jotransparente kompanisë së Adrian Shatkut, UNITEL-it, gjegjësisht konzorciumit Dardafon është konsideruar si shumë të dëmshme nga ekspertët e fushës. Megjithatë, ministri i ekonomisë dhe finansave thjesht e përkrahu këtë kontratë duke injoruar kështu zërat e profesionistëve se mund ta dëmtojë Valën në masën prej 70%. Vetëm sa për ta përmendur se udhëheqësi i UNITEL, Adrian Shatku, ka qenë i paditur nga vetë PTK për terminim ilegal të thirrjeve telefonike, gjë që nuk i pengoi ministrit Shala për ta mbrojtur kontratën me këtë person në disa raste.

Në rrethana krejtësisht të fshehta, në emër të PTK-së u nënshkrua një kontratë tjetër me potencial shkatërrues, ajo për futjen e PTK-

Varësia nga shikimi jashtë

Kur botën e kaploi kriza financiare, mes shumë artikujve të shkruar në gazetën e Kosovës, kishte edhe mjaft të atillë që i shikonin me sy të veçantë shtetet që janë zotuar për donacione për Kosovën. Tash pas krizës, pyeste publiku, a do të na i japin paratë që na i kanë zotuar?

Visar YMERI

Kosova vlon nga anomalitë. Varfërinë e kemi 45% (me atë të skajshme në 18%), ndërkohë që njihemi si vend me pasuri të përqendruar dhe të shumtë nëntokësore (supozohet se vlera e përgjithshme e linjtit e përkthyer në rrymë elektrike është diku 70 miliardë euro, ndërsa kombinati Trepça vazhdon ta ketë nën tokë një shumë marra mendëse të parave). Madje nuk kemi as rrymë elektrike. Papunësinë (zyrtare) e kemi 46%, ndërkohë që afërsisht 450 milionë euro nga fondi i privatizimit nuk futen në sistemin ekonomik-monetar të vendit për zhvillim. I kemi diku 350 mijë hektarë tokë pune e importojmë miell e grurë, specat e domate, tranguj e qepë. Në Kosovë gjatë vitit 2008 kanë qenë gjithsej 466 mijë nxënës në sistemin arsimor (në të gjitha nivelet), të cilët e vijonin mësimin në kushte absolutisht të padenja, nëpër klasë të vogla me nga 30-35 nxënës, nëpër shkollat pa kullm dhe nganjëherë pa nxemje, nëpër shkollat me mungesë bankash. Këta nxënës mësohen nga gjithsej 24 mijë mësimdhënës të paguar keq (rrogë mesatare prej 190 eurosh, që nëse janë e ardhura e vetme në një familje gjashtanëtarëshe, është familje që jeton në varfëri), rrjedhimisht të pamotivuar dhe të dërrmuar (për shkak se kështu janë duke jetuar që prej vitit 1990). Mirëpo Qeveria e ka ndërmend t'i investojë 80 milionë euro të PTK-së në bërë optikë për këto shkollat dhe për këta nxënës e mësimdhënës. Kosova do ta prodhonte vetë bukën e gojës me vetëm 30 milionë euro subvencionim bujqësi në vit, përderisa ne pjesën më të madhe të grurit/miellit e importojmë. Këtu ndahen nga buxheti 360 mijë euro për t'ua paguar qiranë 1,564 familjeve të zhvendosura dhunshëm nga pjesa veriore e Mitrovicës nga strukturat paralele të Serbisë (shumë kjo që, sipas Institutit GAP, do të mjaftojë për një qira modeste për vetëm 300 familje), ndërkohë që ndahen dhe shpenzohen 15 mijë euro për kremten e përvjetorit të pavarësisë, në të cilën kemi dëgjuar fjalime të politikanëve, kemi parë fëmijët e shkollave fillore të veshur me pelerina nga materiali plastik me flamurin e Ahtisaari-t (dhe Tina Kaidanow-it) në mes, si dhe e kemi dëgjuar Filharmoninë e Kosovës dhe koncertin në qendër të Prishtinës.

Raportet më të mira ekonomike dhe

tregtare i kemi pikërisht me vendet që nuk na kanë njohur, apo me vendet që kanë historik të bujshëm të shtypjes, përndjekjes dhe gjenocidit ndaj shqiptarëve. Prej vendeve që eksportojnë në Kosovë, e dyta në listë është Maqedonia (shqiptarët atje janë ende skajshmërisht të diskriminuar dhe të përndjekur); e përcjellur nga Serbia (a do kjo koment?!); me Greqinë në vendin e pestë në listë (edhe sot e kësaj dite Greqia nuk e pranon gjenocidin e kryer ndaj shqiptarëve në Çamëri dhe pretendon ta okupojë pjesën jugore të Shqipërisë, duke e quajtur atë tokë greke; dhe Kosovën e konsideron si pjesë të Serbisë), ndërkohë që një numër të konsiderueshëm të kontratave të majme janë duke i fituar firmat e Izraelit (as ky nuk na ka njohur dhe as që flet për një gjë të tillë). Për më tepër, me përjashtim të Maqedonisë, Kosova nuk eksporton fare në këto vende (për mars të vitit 2009 eksporti në Greqi ka qenë 0.3%, ndërkohë që në Serbi 0.4%).

Por anomalia më e madhe, që reflekton njëkohësisht aspektin më të dëmshëm të mendësisë politike në Kosovë, janë paratë: 1 miliardë e 150 milionë euro (500 milionë të buxhetit + 450 milionë të privatizimit + 200 milionë euro profit i PTK-së) të Kosovës mbahen në depozita bankare brenda dhe jashtë tregut të Kosovës, ndërkohë që politikanët ekzaltohen jashtë çfarëdo kuptimi për 1 miliardë e 200 milionë euro të zotuar në konferencën e donatorëve. Nuk i shfrytëzojnë paratë që i kanë, dhe përulen para atyre që u kanë thënë se do t'ua japin ca.

Paratë që i ka Kosova në të gatshme janë para që do të mund të orientoheshin në zhvillimin ekonomik të vendit. Dikush mund të thotë se nuk janë kushedi se çfarë parash. Janë 1 miliardë e 150 milionë euro sado shumë a pak të jenë këto. Natyrisht që nuk duhet pretenduar se po të futeshin këto para menjëherë në investime në Kosovë (në cilindo sektor), Kosova tërësisht do të shndërrohej në kopsht me lule. Apo se do ta zgjidhnim skamjen me shkop magjik. Mirëpo është më e e paqëndrueshme të thuhet se ato nuk do të kishin asnjë ndikim. Për shkak se paraja e gjenëron paranë. Investimet kanë kthime, qofshin ato afatshkurta apo afatgjata, dhe që të dyja janë të nevojshme në Kosovë. Ta japim një shembull të thjeshtë: po të investoheshin një pjesë e këtyre parave në

bujqësi, në formën e subvencioneve apo kredive pa kamatë për bujqit. Kjo do t'i nxiste bujqit të prodhojnë produkte bujqësore. Këto produkte bujqësore do të shiteshin në tregun e Kosovës (të ndihmuar me politika mbrojtëse), çmimi i të cilave do të mund të kushtëzohej nga Qeveria (meqenëse ajo ka investuar aty). Konsumatorët do të ishin të kënaqur për shkak se do të blenin produkte të freskëta dhe me çmim të vulltshëm. Bujqit do të ishin të kënaqur për shkak se do të përfitonin nga puna e tyre. Buxheti i Kosovës do të ishte i kënaqur për shkak se do të vilte tatime nga bujqit. Këto tatime do t'ia kthenin paratë e investuara qeverisë (natyrisht jo të gjitha dhe jo menjëherë, mirëpo do të ktheheshin). Ndërkohë që bujqësia do të punësonte njerëz shtesë, dhe këta do të paguanin tatim në të ardhura. Prapë buxhetit të shtetit do t'i shtoheshin të hyrat. Ta zëmë se jemi duke synuar tjera gjëra, industri në vend të bujqësisë. Atëherë këto para do të mund të investoheshin në prodhim të energjisë elektrike. Çmimi i ndërtimit të kapaciteteve për një MWh është përafërsisht 1 milion euro. Pra me këto para do të mund të ndërtonim kapacitete për 1000 MWh (gjysma e Kosovës së Re për të cilën po na thonë se doemos duhet të jetë kompani private për shkak se Kosova nuk ka para për ta ndërtuar atë!). Energjia elektrike është bazë për industrinë. E atë aktualisht nuk e kemi. Nëse jo këtu, atëherë në revitalizim të Trepçës nga e cila do të mund të krijonim përfitime të mëdha (shitje të prodhimeve të metaleve, minatorë në punë, etj.). Në periudha të ndryshme Trepça ka qenë eksportuesi më i madh në Jugosllavi. Atëherë pak ia kemi parë hairin meqenëse përfitimet i vilte okupatori. Edhe atëherë paratë tona mbaheshin jashtë Kosovës. Sikur tash.

Po pse të mos e bëjmë këtë me donacione, do të mund të thuhej. A nuk është më mirë që dikush tjetër të na i paguajë shpenzimet? Jo sepse paratë e huaja shkaktojnë varësi. Kjo është pikërisht paradigma e politikës së sotme në Kosovë, e cila mund të përmbledhet në këtë fjali: të tjerët do t'i kryejnë punët tona. Mirëpo kjo fjali, më shumë se sa për të tjerët, flet për ne. Flet për varësinë tonë nga të tjerët, e jo për dashamirësinë e të tjerëve ndaj nesh. Shtetet, mike apo armike qofshin ato, e bazojnë këtë miqësi apo armiqësi në intere-

sa. Ato të ndihmojnë (vetëm) deri në atë masë sa u lehtësisë edhe atyre. Dhe këtë ndihmë duhet shpërguar. Jo të gjitha janë donacione, por ka në atë mes edhe kredi. Donacionet që janë zotuar për Kosovën do të shpenzohen vetëm në ato projekte me të cilat pajtohet edhe donatori. Kjo është shkalla e parë e varësisë. Pra Kosova nuk do të jetë e lirë të vendos se ku do të shkojnë ato. Banka Botërore dhe USAID të dyja janë donatorë në projektin e ngritjes së kapaciteteve energjetike në Kosovë (kryesisht të interesuara për Kosovën e Re). Të dyja këto janë në luftë të vazhdueshme se si do të duhej të shkohet përpara me projektin. Qeveria e Kosovës është spektator në këtë luftë. Ajo po pret që ta kuptojë se cilën rrugë duhen ta miratojë, dhe ta shesë si vendim të saj. Jo të gjitha projektet që do të financohen nga donacionet kanë levërdi ekonomike për Kosovën. Madje disa projekte që do të ndihmohen nga donatorët janë absolutisht të dëmshme për Kosovën (p.sh. decentralizimi). Me paratë tona ne do të zgjedhnim ku dhe sa do të investonim (kur them ne nënkuptoj Kosovën sovranë pa misionë sunduese dhe me qeverisje vendore). Ne do t'i përcaktonim nevojat tona dhe do t'i financonim ato (ta zëmë, sikur shembujt më lart, e ndoshta ka edhe mundësi shumë më të levërdishme të cilat nuk janë përmendur).

Kur botën e kaploi kriza financiare, mes shumë artikujve të shkruar në gazetën e Kosovës, kishte edhe mjaft të atillë që i shikonin me sy të veçantë shtetet që janë zotuar për donacione për Kosovën. Tash pas krizës, pyeste publiku, a do të na i japin paratë që na i kanë zotuar? Kjo na e dërgonte shikimin jashtë. Si i kanë punët financiarisht këto shtete se na mori lumi. Për një moment e harronim gjendjen tonë të padurueshme ekonomike dhe brengosëshim për Gjermaninë. Dhe na interesonte që atje të bëhej mirë, se pastaj (vetëm) kështu mund të shpresonim të bëhej mirë për ne. Për një moment ishim të gatshëm t'ua jepnim paratë tona atyre që të dalin nga kriza (natyrisht të vetëdijshëm që ato nuk do të çojnë shumë peshë), në mënyrë që ata pastaj të na i kthejnë si donacion dhe të na ndihmojnë. Ndërkohë që tërë kohën i kishim paratë tona në banka. Barkun e kishim të zbratur dhe shikonim jashtë, duke vajtuar sofrën në varfërim të të tjerëve. Thua anomali? Paj kjo, fatkeqësisht, na është shndërruar në normalitet.

(Vazhdon nga faqe 4)

ish-ministrit të energjetikës, Et'hem Çekut, i cili kishte bërë një plan për mbylljen e KEK-ut si kryetar bordi i kësaj kompanie në ndërkohë që i printe Komitetit për ndërtimin e termocentralit Kosova C, projekt ky për interesa tërësisht private të kompanive të huaja. Rasti i PTK-së mund të shërbejë si një rast shkollor për të studiuar problemet me proceset e tenderëve të rëndësishëm publik. Tenderi për operatorin e dytë të telefonisë mobile i organizuar në vitin 2007 ishte shumë më i korruptuar sesa rasti i tre vjetëve më herët, kur pas ankesave të bizneseve amerikane Qeveria e atëherëshme e udhëhoqur nga Bajram Rexhepi anuloi tenderin. Organizuar nga e njëjta përbërje e ART-së që dështoi për të parën

herë tenderin, e bërë në një formë shumëfish më të korruptuar, më 2007, një konzorcium u detyrua të tërhiqet për t'ia lëshuar vendin një konzorciumi brenda së cilit ishte kompania amerikane Albright Group. Sot Kosova është në prag të privatizimeve në sektorin energjetik, sektor ky dukshëm i ndikuar nga Bearing Point, një grup ekspertësh që për publikun është tepër pak i njohur. Në një punëtori ku u sollën tok kryeministri, ministri i ekonomisë dhe ministrja e energjetikës, punëtori kjo e hapur nga ambasadorja Tina Kaidanov, një ekspert i këtij grupi thjesht dhe haptas tha se Kosova nuk duhet të presë që të marrë çmimet e rajonit për privatizimin e kompanive publike. Këtij konstatimi që paragjykon vlerën e pasurisë

publike kosovare iu përgjigj i lumtur ministri i ekonomisë me fjalët "ne kemi nevojë për një partner strategjik" edhe pse e dinte ose jo projektet që po përgatiten në fushën e energjetikës siç është ai i termocentraleve të reja nuk përfshijnë pjesmarrjen publike duke bërë kështu që praktikisht të mos ketë fare partneritet.

Natyrisht, në këtë aspekt nuk mund të fajësohet as Bearing Point, por as kompanitë private, të cilat thjesht veprojnë qoftë edhe në mënyrë të egër për të mbrojtur interesin e kompanive që vijnë nga vendi shtetas të së cilit janë. Problemi qëndron në atë se udhëheqësit politik kosovar ndihen krejtësisht të pafuqishëm për të vepruar

kundër iniciativave të tilla zvatëse dhe një pjesë e kësaj pafuqie buron pikërisht nga mosnjohja e problemeve. Në një takim me një zyrtar të lart kosovar kur Organizata ÇOHU! ka pyetur pse është kaq i ngutshëm privatizimi i kompanive fitimprurëse (nëse llogaritet realisht edhe KEK-u përkundër demonizimit është fitimprurës), ky zyrtar tha se "të huajt po na quajnë komunistë nëse kundërshtojmë privatizimin". Vetëm një kërkim i thjesht në internet do t'iu mjaftonte zyrtarëve të lart që të kuptojnë se nuk është quajtur komuniste për shembull Sllovenia, e cila as sot e kësaj dite, si anëtare e BE-së nuk ka privatizuar disa sektorë me rëndësi strategjike për shtetin.

Aktualisht Kosova është në prag të vendimeve në ekonomi që do të kenë pasoja ose rezultate për dekada me radhë. Nëse në krye të këtyre proceseve vendosen njerëz të paaftë dhe të paintegritet, Kosova rrezikon të shndërrohet në një vend që do t'i ngjajë shumë një kolonie që nuk ka kufizime në eksploatim. Kjo nuk mund të lejohet të ndodhë në emër të kurrfarë ideali a miqësie duke qenë se nëse vazhdojnë këto praktika Kosova rrezikon të ngelet një vend pa ekonomi. Kosova duhet të insistojë në mosprivatizimin e kompanive prej të cilave ka përfitime. Ato që më të vërtet mund të shtojnë vlerën me privatizimin duhet të vlerësohen realisht dhe jo thjesht të jenë vetëm pre e politikës së

PËRPARA DREJT FEUDALIZMIT

“Kosova ka nevojë për kalimin prej qytetarit të reduktuar në individ që ka pronë, tek qytetari në shoqëri që ka shërbime të mira publike. Nga qytetari të cilit ia kanë mbjellur në kokë që të drejtat t'i perceptojë si mbrojtje prej nacionalizimit të pronës që mund ta bëjë shteti, tek qytetari i cili i sheh të drejtat e tij si mbrojtje të obligueshme që duhet t'ia ofrojë shteti. Pra, nga shteti që i jep prioritet mbrojtjes së pronës me çdo kusht, te shteti që siguron të drejtën e punës dhe minimumin e mirëqenies për qytetarët. Për këtë qëllim, para së gjithash, lypet ndërrim i paradigmes: nga ekonomizimi i politikës - te politizimi i ekonomisë.”

Albin KURTI

Miti më i ri i kapitalizmit - ai i të qenit të tij i globalizuar - ka pasur shumë sukses në Kosovë. Nga izolimi i gjatë dhe i dhunshëm, qytetarët e Kosovës e dëshironin dëshpërueshëm bërjen e tyre pjesë të botës. Globalizimi u përfytyrua si neutralitet botëror gjithëpërfshirës, duke u shpërfillur fakti se ai ka hierarki, dhe se integrimi në kapitalizmin global bëhet nga poshtë. Meqenëse Kosova ishte tërësisht e varur nga UNMIK-u, qytetarët e saj nuk u integruan në globalizëm si shtet, por më parë si individë. Ata nuk u lejuan të shkojnë në botë (përveçse si refugjatë), ndërkaq bota erdhi tek ata (si sundimtare). Ishte shumë e vështirë për vendasit të dilnin nga Kosova si njerëz ose mallra, porse ishte fare e lehtë për të tjerët që të hyjnë në Kosovë, qoftë si njerëz apo si mallra. Politika fiskale privilegjonte tregtarët e huaj dhe shtypte prodhuesit e paktë vendas. Produktet finale të Serbisë nuk paguanin 10% taksë doganore kur hynin në Kosovë për dallim prej lëndës së parë kur ajo importohet nga ndërmarrësit kosovarë. Deficiti i jashtëzakonshëm tregtar dhe investimet e pakta direkte, dhe atë kryesisht në sektorin bankar, vazhdojnë të jenë tiparet dominuese edhe të Kosovës së pavarur.

Të gjithë e dimë se ShBA-ja, BE-ja dhe shtetet e fuqishme apo perandoritë e tjera e mbështesin me ngulm bujqësinë e tyre vendore, por tek ne ato nuk e kanë lejuar këtë gjë. Në vend se të mbrohet prodhimi vendor, na kanë thënë që duhet të orientohejmë në eksport. Të tillë vazhdojmë ta kemi politikën fiskale edhe sot e kësaj dite. Liberalizimi gjithsesi ndodhi para privatizimit. Dhe, liberalizëm vetëm në njërin kahje, natyrisht. Kreditë bankare që iu ofruan njerëzve (edhe në Kosovë, anipse me kamata të larta) kishin synimin e tyre tradicional që mbiprodhimi i vendeve të zhvilluara të zbutet me mbikonsum (edhe në Kosovë, anipse nuk jemi akoma as vend në zhvillim).

Privatizimi gjithsesi nuk ka qenë i drejtuar vetëm tek ndërmarrjet joeficiente, por tek të gjitha ndërmarrjet. E gjithë strategjia ishte kronostrategji: kur do të privatizohet (sepse teknikisht s'ishte e mundur të privatizohen të gjitha përnjëherë) dhe jo çka ose si të privatizohet. Fuqia e lirë

punëtore (për shkak të papunësisë së madhe dhe mosorganizimit të punëtorëve), mungesa e shqetësimeve për ambientin, sigurinë në punë dhe kujdesin shëndetësor, u interpretuan me pëshpërtje si përparësi jona. Besohej se kjo na bën më joshës. Privatizimi i këtellë nuk e shndërroi pronën në kapital, por më parë ndodhi e kundërta: kapitali u shndërrua në pronë. Pasi i rrekosën mirë e mirë fabrikat, privatizimi i transformoi ato në qendra tregtare dhe hymë në fazën e kapitalistëve pa kapitalizëm - një emër tjetër ky për feudalët. Një pjesë e madhe e prodhimit edhe ashtu të vogël nuk bëhej për tregun (kapitalizmi), por për vetveten (feudalizmi). Mediat u vërshuan nga propaganda për nevojën e ndërmarrjeve të vogla e të mesme, që nuk mund të zhvillojnë sindikata të fuqishme për shkak të numrit të vogël të punëtorëve, që nuk kanë kurrfarë shanse në garë me korporatat, që s'do të merren me mineralet dhe energjinë, pra, me pasuritë e mëdha të Kosovës, e të cilat planifikohet t'i eksploatojnë pikërisht korporatat e huaja në këto dy vitet në vijim. Pikëvështrimi rajonal i Brukselit dhe Washingtonit mbi Ballkanin perëndimor u përkthye në agjendë të brendshme të Kosovës, që sundohej nga vetë misionet e këtyre të ne, duke e futur, kështu, Kosovën në garë me shtetet e rajonit për ta lënë atë tërësisht të shfrytëzuar si më e dobët që është.

Privatizimi u bë në një kohë kur Kosova e porsadalur nga lufta nuk e kishte rimëkëmbur ekonominë. Zyrtarja e lartë e AKM-së, Marie Fucci, e pat bllokuar procesin e privatizimit për shkak të politikave operacionale (gjë që e bëri më të dëshirueshëm privatizimin duke ngjallur iluzione se ai është shpëtimi). Në fakt, ankesat e Serbisë në zyren ligjore në Nju Jork ishin sfidimi i suksesshëm bllokues. Meqenëse popullit të Kosovës nuk i ishte pranuar e drejta për vetëvendosje, për pasojë, nuk ndodhi dekolonizimi para privatizimit. Ndërmarrjet shoqërore deri në vitin 1989, kur u suprimua autonomia e Kosovës, ishin prona të qytetarëve të Kosovës, që për titullar prone kishin komunat përkatëse. Mirëpo, përgjatë viteve të '90-ta regjimi i Milosheviqit i shndërroi këto ndërmarrje të Kosovës në degë të ndërmarrjeve të ndryshme të Serbisë dhe ua nënshtroi ato një privatizimi të pjesshëm nga i cili përfituan ndërmarrësit privatë nga Serbia, që i kontrollonte vetë regjimi, si dhe kompani të huaja, kryesisht

greke e italiane. Në mungesë të vetëvendosjes, në thelb të së cilës ndodhet dekolonizimi si korrigjim historik i tjetërsimit të pronës dhe resurseve natyrore të vendasve, edhe sot e kësaj dite fondi i privatizimit me mbi 450 milionë euro mbahet i bllokuar jashtë Kosovës, me ç'rast edhe Serbia e kreditorët e jashtëm kërkojnë hise aty. Sikur të ishte bërë dekolonizimi, nuk do të bëhej fjalë që borxhet e ndërmarrjeve të Kosovës gjatë viteve të '90-ta t'i paguajë Kosova por Serbia, dhe vetëm ajo - si okupatore dhe shfrytëzuese që ishte.

Misioni i OKB-së në Kosovë, UNMIK-u, vepronte në kundërshtim me parimet e OKB-së edhe në sferën e ekonomisë dhe pasurive. Në Rezolutën 1803 (XVII) të Asamblesë së Përgjithshme, Kombet e Bashkuara kanë deklaruar “të drejtën e popujve dhe kombeve për sovranitet të përhershëm mbi pasuritë dhe resurset natyrore” (Kësisoj thuhet edhe në Kartën mbi të drejtat Ekonomike dhe Obligimet e Shteteve, GA Rez. 3291 (XXIX)), ndërsa Konventat Ndërkombëtare mbi të Drejtat Humane, në Nenin 1(2) afirmojnë të drejtën e popujve “për të disponuar lirisht me pasuritë dhe resurset natyrore”. Mohimi i kontrollit me resurset natyrore është mohim i vetëvendosjes, ndërsa eksploatimi nga ana e kompanive të huaja është tipar themelor i neokolonializmit.

Përkundër mosshfrytëzimit të fondit të privatizimit të deritanishëm duket qartë që privatizimi i mëtutjeshëm, mu në trajtën neokolonialiste, vetëm sa do të përshpejtohet. Synimi i radhës, mbase tani që u bë më të pavarur (sic), është përqendruar mu te ndërmarrjet më të suksesshme apo tek ato që posedojnë pasuritë kryesore të Kosovës: PTK, Trepça, KEK-u, Aeroporti i Prishtinës etj. Jo vetëm që s'pati dhe nuk lejohet referendumi si mjet demokratik lidhur me privatizimet, por madje nuk pati dhe as nuk ka debate publike. Në këtë aspekt, thjesht, asgjë s'ka ndryshuar që prej shpalljes së pavarësisë: vendimet merren në zyra me pak veta dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës janë soditës të zakonshëm sikurse të gjithë qytetarët e tjerë të Kosovës, kurse vetes i thonë përfaqësues të popullit.

Privatizimi në Kosovë nuk e ka bërë kalimin e thjeshtë nga socializmi në kapitalizëm, por në një lloj të veçantë të kapitalizmit: në neoliberalizëm. Në vitin 1999 ka ndodhur abstraktimi i dyfishtë: abstraktimi i mundësive tjera


jashtë kapitalizmit dhe abstraktimi i mundësive tjera brenda kapitalizmit (përveç atij neoliberal). Prandaj, Kosova nuk u shndërrua në një komb-shtet, që do të ishte tipik për kapitalizmin e epokës moderne, pra, industrializmin, por si kthim në feudalizëm me dallimin që as bujqësi me tamam s'kemi. Teknologjia informative dhe komunikuese në formën e *laptop-ëve* dhe celularëve pati efekt maskues: kosovarëve u dukej se janë në hap me botën, porse marrëdhëniet ekonomike, shoqërore dhe politike vazhdojnë t'i ngajnë shumë më tepër feudalizmit. Aq shumë gjëra tregojnë andej: nuk kemi industri, lulëzon nepotizmi, është zvogëluar shkrim-leximi dhe është rritur analfabetizmi, ka gjithnjë e më pak para *kesh* dhe është shtuar shkëmbimi mall me mall, etnia (si eufemizëm për *fis*n nga periudha e kolonializmit) është bërë cilësia kategorizuese dhe jo kombi, kryeqyteti Prishtina është rritur së tepërmi jo si pasojë e industrializmit, por e burokratizimit me zyra të perandorive, kemi më pak ujë dhe drita në sistemin furnizues publik dhe më shumë puse dhe gjeneratorë privatë, zbatohet decentralizimi që e shkatëron shtetin, duke krijuar regjione autonome të dobëta përballë perandorive të fuqishme, lokalizmi krahinor i partive politike me liderë prej bajraktarësh, biznesmenë feudalë rreth tyre që janë bërë pronarë tokash afër magjistraleve, aeroportit apo aty ku do të jenë minierat e ardhshme, dhe mbi të gjithë këta - mbreti dhe mbretëresha e Kosovës: Pieter Feith dhe Tina Kaidanow. Sigurisht që nuk e duan një ecje normale të Kosovës si një shtet solid të tipit shtet-komb evropian, e me ekonomi nacionale. Sepse, nuk e duan kapitalizmin e llojit menaxherial ku do të vinte në shprehje kolektivja, mirëqenia, punësimi dhe barazia që i referohet meritave a nevojave. Pra, asnjëherë nuk e duan një kapitalizëm që, pikësepari, e mbron ekonominë kombëtare prej konkurrencës ndërkombëtare, siç e kemi pasur rastin p.sh. me Slloveninë. Në vend të kësaj, qysh prej fillimit, kishim instalimin e kapitalizmit neoliberal ku theksohej individualizmi, zgjedhja (që u bë zgjedhje jopolitike: njerëzit zgjedhin veçse pastën e dhembëve, destinacionet turistike ose kanalet televizive), liria (si liri e tregut dhe jo e njerëzve), barazia (si barazi e mundësive që realisht është e pamundur), dhe ekspozimi flagrant i ekonomisë kombëtare ndaj konkurrencës ndërkombëtare gjë që, në rastin e Kosovës, as nuk e la të lindte ekonominë e vendit. Duke e mbajtur një shtet të dobët të Kosovës,

shtet sa për sy e faqe, e kanë pamundësuar redistribuimin e të mirave materiale si dhe ndërhyrjen në akumulimin e kapitalit. Kosova është avangardë botërore, shembull pararendës i derregullimit para rregullimit - derregullim pa pasur rregullim paraprakisht.

Megjithëkëtë, shteti i dobët (venditor) nuk do të thotë edhe pushteti i dobët (ndërkombëtar). Përkundrazi. Stabiliteti brenda në Kosovë, tash 10 vjet, mbahet me forcë, në mënyrë që depërtimi i kapitalit dhe mallrave nga jashtë të bëhet pa forcë. Policia, gjyqësia dhe ushtria e bëjnë shtypjen e popullit, ndërkaq politika, mediat, shkollimi dhe analistët - menaxhimin e publikut. Këto gjithsesi janë dy anët e së njëjtës medalje që Louis Althusser i quan Aparatet Represive Shtetërore dhe Aparatet Ideologjike Shtetërore.

Përgjithësisht, ardhja e kapitalizmit në Kosovë i përngjan më shumë modelit rus sesa atij kinez: janë shkatërruar institucionet e vjetra duke u synuar një rend i ri shoqëror e politik në shërbim të privatizimit masiv. Ky privatizim bëhet për hir të parimit, për hir të vetvetes, sikur të ishte një e vërtetë shkencore. Kurrfarë *boom*-i ekonomik nuk mund të ngajë asnjëherë në Kosovë siç ëndërojnë zgjuar ministrat e saj, sepse koordinatat e Kosovës janë po ato të Rusisë së Boris Jelcinit. Edhe pasojat do të përputhen (ndonëse jo në përmasat sasiore ruse): kontrabanda, krimi i organizuar, politikanë super të pasur dhe ekonomi e zënë peng nga mafia. Kina e ka zgjedhur rrugën e vet drejt kapitalizmit, ndërkaq Kosovës (sikurse Rusisë) ia kanë zgjedhur. Sigurisht që nuk mund të thuhet se Kina është bërë kopsht me lule, por, me po të njëjtën siguri mund të thuhet që Kosovën e kanë bërë kopsht me plehëra.

Kosova ka nevojë për kalimin prej qytetarit të reduktuar në individ që ka pronë, tek qytetari në shoqëri që ka shërbime të mira publike. Nga qytetari të cilit ia kanë mbjellur në kokë që të drejtat t'i perceptojë si mbrojtje prej nacionalizimit të pronës që mund ta bëjë shteti, tek qytetari i cili i sheh të drejtat e tij si mbrojtje të obligueshme që duhet t'ia ofrojë shteti. Pra, nga shteti që i jep prioritet mbrojtjes së pronës me çdo kusht, te shteti që siguron të drejtën e punës dhe minimumin e mirëqenies për qytetarët. Për këtë qëllim, para së gjithash, lypet ndërrim i paradigmes: nga ekonomizimi i politikës - te politizimi i ekonomisë.



Kosova në krizën globale financiare

“ Problemi themelor është se Kosova nuk ka kapacitete të planifikimit dhe zbatimit të një programi zhvillimor ekonomik. Në dallim prej shumë vendeve të rajonit, Kosova nuk ka një agjension të zhvillimit ekonomik, as programe efektive që shkojnë drejtë nxitjes së eksportit si bazë për rritje ekonomike, ndërsa eksporti është nyja themelore që krijon lidhjet midis ekonomisë vendore dhe tregut global.”

Besnik PULA

Është bërë e zakonshme nëpër medime informative që të theksohet rritja e popullaritë të Kapitalit të Marksit me shpallimin shokant të krizës globale financiare gjatë muajve të fundit. Në anën tjetër, disa nga e majta tashmë kanë filluar të shpallin triumfalisht fundit e projektit neoliberal dhe ardhjen e një epoke të re ku, sipas këtyre, do të shohim ardhjen në shprehje të formave më 'socialiste' të organizimit ekonomik, siç janë nacionalizimi i bankave (që tashmë po ndodh gjithandej vendeve postindustriale), taksa në shkallë progresive dhe masa të tjera që i japin fund ekcesive të kapitalizmit financiar që ishin shkaktarët fundamental të krizës aktuale. Në Amerikë kjo frymë ka marrë hov gjithashtu me fitoren ektorale të Barack Obama-s dhe të demokratëve, duke shpallur kështu sipas disave një epokë të re post-neoliberale.

Rreziku i pranimit të kësaj narrative qëndron në atë se ai fokusohet në trendet afatshkurtëra dhe nxjerr krizën aktuale nga kuadri më i gjerë i transformimeve ekonomike që kanë ndodhur gjatë tri dekadave të fundit në vendet e zhvilluara kapitaliste. Padyshim, edhe ekonomistët më të regjur neo-klasikë (baballarët ideologjikë të neoliberalizmit) kanë parasysh se kriza e sotme tejkalon përmasat e një krize "normale" ciklike të akumulimit kapitalist, të të ashtuquajturve "business cycles" në të cilat tregu i riadaptohet një ekuilibri të ri të raportit ofertë-kërkesë. Kriza dhe falimentimi i shpejt i shumë bankave dhe institucioneve financiare dhe i institucioneve të mëdha të siguracioneve sikur American International Group (AIG), në një formë që përnjëherë kanë reduktuar praninë e kreditit në ekonomitë e zhvilluara (aq të domosdoshëm për investime si dhe për mbajtjen e nivelit të konsumit) qartazi shkon përtej një krize afatshkurtëre dhe një tkurrje normale ekonomike çfarë pritet prej një recesioni. Intervenimi i paprecedent i shteteve në subvencionimin e humbjeve ekonomike të bankave dhe institucioneve financiare të mëdha dhe humbja e qindra trilardë dollarëve në vlerë të tregjeve globale financiare dëshmon për shkallën e jashtëzakonshme të krizës aktuale. Kjo, natyrisht përmben vetëm efektin ekonomik të krizës. Efekti i tij përmes ngarkesave të përnjëhershme që ajo i ka bërë buxheteve shtetërore, duke shkaktuar rënien e të hyrave tatimore, obligimin për të ndërhyrë me para të reja në ekonomi për të parandaluar një kolaps total ekonomik, ngarkesat e reja në shërbimet sociale si pasojë e rritjes së papunësisë, janë pasojat tjera të krizës të cilat tashmë po gjenerojnë dinamika dhe kriza të reja politike në gjithë globin.

Tashmë për shumikë është gjithashtu i qartë shkaku themelor i krizës. Ishte vetë aparatura globale financiare që, përmes produkteve 'inovative' financiare, të të ashtuquajtura 'securitization', e nxitur nga korniza e dobët rregullative e favorizuar me dekada nga ideologjia neoliberale (nocioni që tregu nuk ka nevojë për mbikëqyrje sepse vetëvetiu korrekton gabimet e veta etj.) dhe dominancës gjithnjë e më të madhe të kapitalit financiar karshi atij prodhues si motor të akumulimit kapitalist, ajo që ushqeu rritjen spekulative të profitit përmes investimeve financiare. Rritja ndodhi pothuajse krejtësisht në krah të tregjeve të patundshmerisë, ku përhapja e kredive nxit blerjen masive të patundshmërive, gjë që artificialisht ngriti çmimet e tyre deri në shkallën kur mospagesat e kredive nga blerësit çoi në tërheqjen e tyre nga tregu, ndërsa bankave u mbetën në duar prona të lidhura për letra krediti pa vlerë në treg. Kolapsi i këtij tregu spekulativ në vitin 2008 kishte vlerë nominale prej afër 800 miliardë dollarëve (11 herë më e madhe se gjithë ekonomia globale) mbi të cilin ishte ndërtuar ngrehina e re financiare ishte nyja e parë në zinxhirin financiar që tërhoqi me vete struktura të tëra financiare duke na çuar në situatën në të cilën gjendemi sot.

Reagimi i disave është që kriza dëshmon për nevojën e rikthimit të rregullimit, kontrollit dhe monitorimit shtetëror të aktiviteteve në tregjet financiare, proces që gjithashtu ndodhi pas kolapsit financiar të viteve 1930. Mirëpo kjo pikëpamje e ngushtë e aspektit rregullativ lë jashtë procesin e transformimeve institucionale të post-fordizmit ku duhet ta kërkojmë shkaku më të madh të situatës së sotme politike dhe ekonomike. Teoria e fordizmit/post-fordizmit rrjedh nga e ashtuquajtura Régulation School e teorisë ekonomike, por që në dallim prej ekonomisë neo-klasike, koncepton kapitalizmin si një formë ekonomike që është në varshmëri të drejtpërdrejtë me institucionet dhe normat jo-ekonomike. Régulation School merr seriozisht vështrimin e Althusser-it se ajo që e dallon historikisht një formacion shoqëror kapitalist (kundrejt atij feudal etj.) është dominanca e instancës ekonomike mbi instancat tjera shoqërore, dukuri kjo e vënë re për ekonomitë e tregut edhe nga babai i traditës institucionaliste në ekonomi, Karl Polanyi. Kundrejt determinizmit njëkahësh të marksizmit ortodoks (se struktura ekonomike është shkaku i superstrukturave shoqërore, politike dhe ideologjike), Régulation School kupton instancat apo fushat e ndryshme institucionale të një formacioni shoqëror si potencialisht autonome, megjithëse të ndërlidhura në mënyrë sistematike përmes të 'coupling' (ndërlidhjeve komplekse kauzale por që megjithatë veçojnë dy sis-

teme kauzalisht të pavarura). Kjo e bën Régulation School më të afërt me traditën institucionaliste në sociologji se sa me ekonominë neoklasike apo edhe me ekonominë politike klasike marksiste. Si pasojë, Régulation School thekson se kapitalizmi, në instancë të fundit, varet nga një mënyrë e riprodhimit (mode of reproduction) që krijon kushtet si shoqërore dhe kulturore (përmes vlerave shoqërore, institucionale etj.), si ato ekonomike (të regjimeve të akumulimit të kapitalit) për zgjerimin e qarqeve të prodhimit, qarkullimit dhe konsumimit të kapitalit. Mënyra e riprodhimit përbëhet nga dy elemente: mënyra e rregullimit shoqëror (institucionet, normat shoqërore, ideologjia etj.) dhe nga regjimi i akumulimit (rrjetet dhe strukturat të prodhimit dhe konsumit që mundësojnë akumulimin afatgjatë të kapitalit). Dyja këto struktura kanë pësuar ndryshime gjatë tri dekadave të fundit.

Sipas teoricientëve të Régulation School, ajo që vështrojmë në vendet e zhvilluara kapitaliste që nga kriza ekonomike e viteve 1970 është një ristrukturim ekonomik që po zëvendëson formën e dikurshme ekonomike të mbështetur në rolin qëndror të shtetit në zhvillimin ekonomik dhe në nivelizimin e ekstremeve të pabarazive shoqërore përmes ndërhyrjeve Keynes-iane, një mënyrë e rregullimit që ata e quajnë Fordizëm, në një formacion të ri post-fordist. Post-fordizmi është pasojë e kontraktave të vetë fordizmit, por edhe të transformimit në shkallë të rrjeteve të qarkullimit të kapitalit ku një ekonomi relativisht e vetëpërbajtur kombëtare e një shteti është zëvendësuar me një ekonomi të ndërlidhur globale si një sferë gjithnjë e më të unifikuar të investimit, prodhimit dhe konsumimit transnacional të kapitalit. Për dallim nga sistemi fordist, postfordizmi mbështetet në "akumulimin fleksibil", që domethënë dominancën e kapitalit financiar, fluiditetin (dhe globalizimin) e qarqeve të prodhimit, me pasojë edhe "kazualizimin" e punës nga një garancë shoqërore çfarë ishte në fordizëm në një pozicion të pasigurt dhe të përkohshëm që çon komodifikimin individual në shkallë të reja duke kërkuar nga individit punonjës që të jetë "fleksibil" në tregun e punës për shkak të jostabilitetit të strukturës ekonomike, të ndjekur me erozionin e të drejtave të punës (pjesërisht pasojë e dobësisë të organizimit sindikal), humbjen e vlerës së punëtorit (sidomos në rangjet e ulta të tregut të punës) me automatizimin e procesit të punës dhe bartjes së prodhimit në vendet e Botës së Tretë, bashkë me vlerësimin e punës simbolike (të shërbimeve komplekse) që kërkojnë përgatitje të lartë arsimore, dhe të mënyrave të reja të organizimit të firmave që hierarkitë e pozitive dikur të distribuuar në bazë të stazhit punues e zëvendësojnë me konkurrencën

e brendshme të punëtorëve. Roli dhe rëndësia e shtetit kombëtar në rregullimin ekonomik dhe social është debat që vazhdon në mesin e atyre që janë pjesë e Régulation School mirëpo padyshim roli i shtetit në kushtet e globalizimit të sistemeve financiare është pa asnjë dyshim krejtësisht tjetër nga ai që mund të ishte para tri-katër dekadave ku planifikimi qëndror në shkallë të shtetit kombëtar akoma ishte i realizueshëm madje edhe në shtetet perëndimore si Franca, Gjermania apo vendet skandinave. Këtë po dëshmon edhe kriza e sotme ku po shihet se mjetet që shteti posedon janë - sidomos për shtetet më të vogla - shpesh joadekuat për t'u përgjigjur në mënyrë efektive një krize që ka si shkak forca që gjenden krejt jashtë sferës së kontrollit dhe jurisdiksionit të tij. Disa parashikojnë se kriza aktuale do të çojë në ngritjen e instancave globale rregullative të kapitalit financiar. Një gjë e tillë mbetet të shihet, megjithëse edhe kjo sjell rrezikun e ndërtimit të një oligarkie financiare që vazhdon t'i lë shtetet më pak të zhvilluara nën mëshirën e institucioneve ndërkombëtare financiare si të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Mirëpo është e qartë se karakteri themelor i krizës aktuale rrjedh nga fakti i vështuar nga teoricientët e Régulation School gjatë dekadave të fundit: se ristrukturimi ekonomik post-fordist po gjeneron, përveç rritjes së pabarazive sociale gjithandej vendeve të zhvilluara dhe të pazhvilluara, gjithashtu dhe krijimin e një strukture ekonomike që, për shkak se mbështetet mbi kapitalin financiar, gjithnjë e më shumë i nënshtrohet ekstremeve të lëvizjeve ekonomike dhe krijon kriza të përmasave globale që nuk kursen asnjë nga vendet që dikur mbijetonin krizat globale të paprekura. Prandaj me të drejtë Marazzi e quan krizën aktuale "kriza e parë e unifikuar e post-fordizmit". Në dallim prej krizave regionale (siç ishin recesioni japonez i viteve 1990, kriza financiare në Azinë juglindore në fundvitet 1990, kolapsi financiar në Argjentinë dhe Brazil etj.), kriza e sotme nuk ka kursyer asnjë nga ekonomitë e zhvilluara. Në aspektin strukturor, ajo çfarë bën kriza aktuale është sjell në pikëpyetje gjithë rolin e kapitalit financiar në sistemin aktual ekonomik global. Siç bëjnë të ditur historianët ekonomik, roli i kapitalit financiar ka pësuar shpërthim që nga vitet 1970 duke përfshirë sot të gjitha aspektet e aktivitetit ekonomik. Në SHBA, p.sh., në vitin 1947 sektori financiar përbënte rreth 2,5 % të Prodhimit Bruto të Vendi (GDP), ndërsa në vitin 2006 kjo kishte arritur në mbi 8 % duke bërë që shërbimet financiare të marrin pjesë me afër 40 % në strukturën e profiteve korporative.

(vazhdon në faqen tjetër)

(vazhdon nga faqja e kaluar)

Rritja e sektorit financiar ndodhi gjatë dhe pas krizës së viteve 1970, paralelisht me ngritjen ideologjike të neoliberalizmit. Si pasojë, sot, në ekonominë e zhvilluara, çdo veprim ekonomik, që nga investimi deri tek konsumi i produkteve, varen drejtpërdrejtë nga kapitali, në radhë të parë në formë të kreditit, i siguruar nga sistemi financiar. Prania e madhe e kreditit ka çuar gjithashtu në rënien e nivelit të kursimeve, jo vetëm në vendet e zhvilluara por edhe në shoqëritë si Japonia dhe Korea Jugore që dikur njiheshin për shkallë të larta kursimi. Kursimi mund të duket si gjithnjë e më i panevojshëm për shoqëri ku te kredia arrihet lehtë dhe përdorimi i tij është i thjeshtë për çdo aspekt të investimit dhe konsumit. Mirëpo, kjo logjikë dëshkohet problematike në momentin që, siç ndodhi tani, krediti zhduket nga ekonomia si pasojë e humbjeve të mëdha në investime spekulative që tërheqin me vete banka të tëra dhe gjithë bazën e kapitalit që furnizon ekonominë me kredi.

Kjo ka çuar në një ndërhyrje të paparë të shtetit në shpëtimin e bankave dhe institucioneve të tjera financiare për subvencionimin dhe pjesëmarrjen direkte të shtetit në pronësinë e tyre. Në këtë pikëpamje, është përmendur shpesh fantazma e socializmit: a është e mundur që edhe në një vend si Amerika, të fillon nacionalizimi i bankave dhe kompanive të mëdha? Mirëpo paradoksi i asaj që po shohim është vënë re nga të tjerët: nëse ky është 'socializëm', është i tillë vetëm për kapitalistët. Shteti fut paratë publike në shpëtimin e investitorëve spekulativ duke shpërblyer riskun e tyre. Arsyetimi është se po të lihen të kolapsonin institucione bankare si Citigroup, Bank of America apo AIG, shoku ekonomik që do të shkaktohej në gjithë ekonominë amerikane dhe globale do të ishte katastrofik duke marrë me vete në varr sektorë të tërë të ekonomisë dhe duke çuar në nivele të papara të papunësisë që nga depresioni i

viteve 1930. Kapitalizmi është bërë tepër i madh për veten e tij që bën të domosdoshme socializimin e humbjeve të mëdha ekonomike në shkallë historikisht të paparë në mënyrë që të evitohen kriza edhe më të rënda ekonomike dhe shoqërore.

Ku i gjejnë këto transformime vendet në zhvillim si Kosova? Shoku i krizës është ndjerë në gjithë vendet "tranzicionale" të Evropës lindore në formën e rënies së aktivitetit ekonomik, devalvimit valutor dhe rrezikut të vazhdueshëm të dështimit të sistemit financiar. Zhvillimi i tillë detyroi që, në vllugun e krizës në mars të këtij viti, shefat e gjithë bankave qendrore të vendeve evrop-lindore të mbajnë një samit të përbashkët për të siguruar për stabilitetin e vazhdueshëm të sistemeve të tyre financiare, pas të dhënave alarmante për rrezikun e kolapsit financiar të lëshuara në fillim të këtij viti. Kriza ekonomike në Evropën lindore është e lidhur ngushtë me fatin e ekonomive të Evropës qendrore, të dominuar nga Gjermania dhe, më pak, nga Austria. Megjithatë rreziqet e kolapsit financiar janë evituar, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) parasheh një rënie mestatere prej 5.2 % të prodhimit bruto (GDP) në gjithë rajonin, që përfshin edhe Ballkanin. Ironikisht, kjo rënie është më e madhe në shtetet baltike që dikur merreshin si modele të transformimit të suksesshëm në ekonomi të tregut. Rënia e GDP-së në këto shtete për këtë vit sillt prej 10-12 %, fakt i varshmërisë së tyre të thellë me ekonominë globale. Edhe pse efektet e krizës kanë bërë që edhe FMN-ja të zbusë insistimet në balansimin e buxhetit dhe të tolerojë deficitet buxhetore që kanë rezultuar si pasojë e krizës ekonomike, në disa vende kriza financiare po përdoret politikisht si arsyetim për politika shumë më drastike buxhetore. Përderisa në vendet e zhvilluara shihet rëndësia e shpenzimeve buxhetore për rigjenerim ekonomik (si p.sh. në SHBA, ku qeveria miratoi shpenzime me vlerë rreth 800 miliard dollarë) në vendet e

vogla kriza çon në shtrëngimin e mëtejme të shpenzimeve publike. P.sh., për këtë vit, kryeministri estonez ka kërkuar reduktim në shpenzimet buxhetore prej 12 %, duke marrë shkas se kriza shërben "për zvogëlimin e mëtejme të shtetit" siç ka deklaruar ai. Kurse, përderisa shtetet e vogla baltike dhe ato të Evropës qendrore dhe lindore ballafaqohen me krizën, shtetet me zhvillim të mesëm si Brazili dhe India synojnë që të dalin nga kriza me një rol më qëndror ekonomik dhe politik. Si përfundim, mund të themi se "kriza e unifikuar e postfordizmit" nuk po çon drejt një unifikimi në formën e masave politike që po merren nga shtetet, as në lindjen e një makro-strukture rregullative botërore, por në fragmentimin e mëtejshëm ekonomik dhe politik (të parë edhe në paaftësinë e BE-së për t'u përgjigjur, si bllok, krizës, duke i detyruar shtetet anëtare në marrjen e masave vetanake). Globalizimi ekonomik, ironikisht, po çon në fragmentimin e vazhdueshëm politik, me efekte që do të vërehen edhe gjeopolitikisht, por edhe në lëvizjet shoqërore brenda vetë shteteve. Mirëpo, ky fragmentim nuk po shkon drejt krijimit të autarkive të reja të ekonomive kombëtare (siç ndodhi në prag të Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore), por të ndarjes së globit në sisteme regjionale ekonomike të organizuara si bllok rreth një ekonomie të zhvilluar me rol dytësor prodhues dhe konsumues për shtetet periferike, me varshmëri të madhe te kapitali i jashtëm financiar për sigurimin e investimeve.

Ku qëndron Kosova në këtë mes? Me disa përjashtime (p.sh., fondin pensional), kriza ka kursyer Kosovën në masë të madhe për shkak të izolimit të saj relativ nga sistemi financiar global dhe qarku i investimeve spekulative që çoi në krizën aktuale. Mirëpo, izolimi i Kosovës, sado është një përparësi, është gjithashtu një problem, sepse mosintegrimi sado periferik në blloqet regjionale ekonomike po çojnë në shndërrimin e Kosovës në një vrimë të zezë në hartën ekonomike të Evropës me probleme ekonomike që prej

prizmit evropian (siç është papunësia prej mbi 40%) duken se edhe në kushtet e krizës aktuale i takojnë një planete tjetër.

Problemi themelor është se Kosova nuk ka kapacitete të planifikimit dhe zbatimit të një programi zhvillimor ekonomik. Në dallim prej shumë vendeve të rajonit, Kosova nuk ka një agjension të zhvillimit ekonomik, as programe efektive që shkojnë drejtë nxitjes së eksportit si bazë për rritje ekonomike, ndërsa eksporti është nyja themelore që krijon lidhjet midis ekonomisë vendore dhe tregut global. Mirëpo problemi nuk është vetëm institucional, ai është edhe ideor - me një elitë të korruptuar politike dhe një sistem të dështuar të studimit të lartë universitar dhe akademik, Kosova nuk ka as kapacitetet e nevojshme intelektuale për t'u përballur me sfidat e zhvillimit ekonomik. Lëvizjet shoqërore, ndërkaq, mbesin tepër të fragmentuara dhe të paafat për krijimin e një platforme progresive që zhvillimin ekonomik do ta kishte bazë parësore të politikës. Si pasojë, edhe në kushtet e krizës aktuale globale, Kosova mbetet peng i zbatimit të politikave ekonomike të institucioneve globale financiare si FMN (në të cilën Kosova para pak kohe fitoi anëtarësinë). Problemi kryesor është se politikat e FMN-së nuk kanë synim zhvillimor - ato synojnë, në parim, stabilitetin makro-ekonomik të vendit, brenda disa kornizave konservatore ekonomike (mbrojtja nga deficitet buxhetore, stabiliteti i valutës, që në Kosovë nuk përbën problem për shkak të përdorimit të euros, dhe nga presionet e inflacionit), që i konsiderojnë si krjm të kushteve për investime. Mirëpo, sipas këtyre parametrave, mjedisi ekonomik në Kosovë ka qenë stabil që nga periudha e menjëhershme e pasluftës. Ndërsa problemi qëndror ekonomik në Kosovë vazhdon të jetë paaftësia e lidershit politik për të kaluar nga një politikë konservatore e stabilitetit makro-ekonomik, çfarë favorizohet nga FMN, në një politikë aktive të zhvillimit që i jep shtetit rol qëndror në orientimin e programeve zhvillimore ekonomike.

Privatizimi dhe Kosova

Safet GËRXXHALIU

Është e vërtetë se tranzicioni në përgjithësi është një ndër proceset më të vështira me të cilin ballafaqohen shtetet të cilat kalojnë nëpër këtë proces dhe në raste të shumta procesi i tranzicionit definohet si një lum i vërshuar pas shirave të egra që në sipërfaqe qesin mbeturina, dhe mund të paramendoni sa kohë nevojitet që ky ujë të kthjellohet dhe ky kthjellim varet nga ajo se në atë vend sa funksionon shteti ligjor, stabiliteti politik, stabiliteti ekonomik, social, etj.

Një ndër sfidat me të cilat janë ballafaquar vendet në tranzicion sidomos në Evropën Juglindore, pa mëdyshje është edhe procesi i privatizimit. Në vende të ndryshme varësisht nga përgatitja institucionale dhe profesionale ka pas suksese dhe është shfrytëzuar si një proces i cili ka gjeneruar zhvillim ekonomik. Në disa vende ky proces është përcjellur me korrupsion, mosprofesionalizëm, klanizëm dhe me shumë dukuri të tjera negative të asaj shoqërie.

Në Kosovë procesi i privatizimit u mirëprit

për arsye të mos posedimit të njohurive bazike se çka nënkupton ky proces, si do të implementohet dhe cilat do të jenë beneficionet e këtij procesi. Themelimi i Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit ka qenë një realitet që dëshmon se në periudhën e Kosovës së pasluftës ka qenë e pamundur të bisedohet për probleme ekonomike të mos marrin edhe ngjyrë politike. Ky politizim në rastin konkret manifestohet në dy forma, e para një politizim intern që nënkupton atë të qasjes kosovare dhe politizim ekstern ku u involvuan edhe qarqe politike nga jashtë, por e veçanta e këtyre involvimeve ka qenë mbrojtja e interesave të grupeve dhe klanëve të caktuara e jo që përmes këtij procesi në Kosovë të arrihet zhvillim ekonomik, hapje e vendeve të reja të punës, përmirësim të bilancit tregtar dhe ngritje pozitive të imazhit të Kosovës.

Se sa ka qenë në fokus të politikave antikosovare ky proces, dëshmon edhe analiza e kohës së menaxhimit të shtyllës së IV-të të UNMIK-ut, nga z. Nicolas Llamdsdorf dhe znj. Maria Fuchi, e cila kishte si duket mision të veçantë që bashkërisht me shumë servil vendorë në AKM t'i pengojë dhe t'i parandalojë efektet pozitive të cilat kishim mundur të arrihen me këtë pro-

ces, me një menaxhim të mirëfilltë. Çka e karakterizon procesin e privatizimit në Kosovë, është fakti i mungesës së transparencës së këtij procesi dhe mungesa enorme e përgjegjësisë qoftë nga ata që e kanë përgatitur këtë proces, por edhe më tepër nga pronarët të cilat kanë marrë pjesë në këtë proces dhe kanë fituar të drejtën e pronësisë, por ajo çka është premtuar dhe paraqitur në dokumentacion qoftë përmes spin off-it apo spin off-it special, nuk është përmbushur pothuajse asnjëherë. Si rezultat i kësaj nga ky proces rrjedhin pakënaqësi enorme të punëtorëve të ndërmarrjeve të privatizuara, ky proces ka qenë burim i tensioneve sociale dhe në fund nga ky proces shumë më tepër punëtorë kanë humbur vende të punës, sesa që kanë fituar gjë që është premtuar se do të ndodhë.

Se vërtetë pakënaqësia e punëtorëve është rritur dëshmon edhe fakti se 20% i premtuar për punëtorët e ndërmarrjeve të privatizuara ende nuk është paguar, dhe kur kësaj i shtohet se mu këta punëtor sot janë të moshuar dhe pa mbështetje financiare për ekzistencë, vetvetiu lind pyetja kujt i shërben një proces i tillë, i shërben më tepër Kosovës dhe ardhmërisë së saj apo armiqve të saj të cilët një pakënaqësi të tillë mund ta përdorin për qëllime të veta

antikosovare. Kishte me qene mirë që të paktën tani kur jemi në prag të përgatitjeve për privatizim të ndërmarrjeve publike të cilat janë vitale për ekonominë Kosovare, të kemi një qasje shumë më serioze, më profesionale dhe është koha kur të kemi edhe të menduar social.

Privatizimi i këtyre ndërmarrjeve do të jetë një sfidë edhe për Agjencionin e ri të privatizimit, i cili është më tepër i kosovarizuar sesa AKM-ja, prandaj është obligim moral që të mos përsëriten gabimet nga e kaluara por nga ky proces të përfitoj Kosova, ekonomia e saj dhe ky proces të jetë gjenerues i stabilitetit qoftë ekonomik, politik apo social.

Në fund të fundit nuk duhet çdo gjë të shitet dhe të shkatërrohet sepse është publike, por nga e tëra kjo duhet të përdoren metodat dhe modelet pozitive që kanë përdorë shtetet të cilat kanë kaluar nëpër këtë proces dhe modeli i partneritetit publiko-privat ka dhënë efekte tejet pozitive. Këtu vlen të theksohet një mendimtar i cili thotë "Nuk është marri të mos dish e të mos kesh nga kush të mësosh, por është marri të mos dish e të kesh prej kujt të mësosh".



Arshavardh

Dështimi në skenë të hapur

Nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore, punëtorët e Kosovës fituan rrugën. Të përjashtuar nga puna tash e 20 vjet punëtorët tanë ballafaqohen edhe me padrejtësitë më banale siç është mungesa e ligjit të punës. Sakrifika dhe vuajtjet e punëtorëve tanë për më shumë se dy dekada mbetën të papërligjura. Kuvendi i Kosovës nuk e pa të udhës as edhe një herë të shtrojë në rend dite çështjen e mbi 200 mijë punëtorëve të Kosovës që padrejtësisht u larguan nga puna në vitet e 90-ta, dhe sot shumica e tyre nuk mund të llogarisin as edhe pensionimin normal siç e kanë kolegët e tyre kudo në botën e qytetëruar.

Adem NIMANI

Parapërgatitjet e profiterëve kishin filluar më herët

Stafi ndërkombëtar drejtues i ndërmarrjeve dhe servilët primitiv vendor

Askush nga stafi ndërkombëtar i menaxhimit të ndërmarrjeve ekonomike e industriale që u vendosen në Kosovë pas luftime nuk kishte menduar se do të mund të bëjnë çka t'iu teket me ndërmarrjet shoqërore e publike në vendin tonë. As stafi vendor që sa për sy e faqe u gjet në përbërjet drejtuese të të ashtuquajturve Borde drejtuese nuk e kishte imagjinuar se do të mund të veprohej pa pengesë dhe gjithçka të privatizohet jashtë çdo rregulli. Punëtorët kosovarë të përjashtuar me dhunë nga vendet dhe ndërmarrjet e tyre si të dehur nga çlirimi i Kosovës sikur menduan se gjithçka ka për të vajtur mbi baza ligjore. Punëtorët besuan se dikush do të përkujdeset për fatin e tyre dhe haruan se do të presin edhe dhjetë vjet pas luftime miratimin e ligjit të punës. Kishin menduar mirë anëtarët e shtyllës së katërt të UNMK-ut se organizmi i vetëm sindikal në Kosovë do të mund t'ua prishte llogaritë, mirëpo shpejt kishin parë se me pak para kreu sindikal do të bëhej anëtar i Bordit të AKM-së dhe kështu ngjau. Që nga themelimi AKM-ja do të veprohte pa asnjë pengesë në privatizimin e çdo gjëje, në raste të caktuara edhe të pronave të kontestuara dhe që gjendeshin në procedurë gjyqësore. Duart e Bordit të AKM-së pas anëtarësimit të të parit sindikal ishin bërë plotësisht të lira. Privatizimi me parregullsi të papara tashmë kishte filluar. Shumë herë AKM-ja shiti edhe pa tender, me një apo pa ofertues. Shumë herë u shiten (falen) ndërmarrjet të mëdha edhe pa u paguar edhe një cent në xhirollogari. U copëtuan mirë e mirë gjigantet si Ramiz Sadiku apo Agrokompleksi për t'ua privatizuar më lehtë dhe për të përçarë tragjikisht punëtorët. Fati i dy ndërmarrjeve të mëdha publike të informimit, i Rilindjes dhe i Radiotelevizionit të Prishtinës as që u vu në rend dite ndonjëherë. Prona e këtyre dy ndërmarrjeve publike u tjetërsua dhe vazhdon të tjetërsohet jashtë ligji edhe sot. U shitën ndërmarrjet të shumta pa llogaritë asnjëherë pasurinë e tyre. Asnjëherë dhe në asnjë rast nuk u bë evidencimi i plotë i pronës ndërsa dihet mirë se shumë ndërmarrje kishin prona jo vetëm në gjithë territorin e Kosovës por edhe jashtë saj. Pa u bërë asnjë përllogaritje u shiten edhe miniera me çmime qesharake si Goleshi apo Karaqeva në Kamenicë. Edhe çka duhet të privatizohet dhe çka do të mbetet derisa të vendoset një rregull ligjor i pranueshëm? Në të gjitha rastet e privatizimit, pa përjashtim, nuk u mor parasysh fati i punëtorëve të mëparshëm. Në vend që me rregullore të përcaktoshin detyrimet e padronëve të rinj, ata u bënë titullar ndërmarrjesh vetëm me premtime boshe, pa asnjë parakusht. Në shumë raste emri i titullarit mbeti anonim.

Derisa punëtorët e Kosovës kishin besuar se drejtësia do t'ua kthej dinjitetin e shkelur më shumë se një dekadë, drejtuesit sindikal po merreshin me gëlltitjen e donacioneve që nuk ishin të vogla pas luftime. Nuk do të vonojë shumë, derisa po studiohej fusha eksperimentale për privatizimin që filloi pas luftime, ata që kishin planifikuar çfarëdo rezistence apo edhe kërkesë elementare të punëtorëve e që nuk do të mund të rrëzohej publikisht, u kujdesën që qysh në hapin e parë të emërojnë në Bordin e AKM-së edhe kreun sindikal. Kështu u vulos edhe shpresa e fundit e punëtorëve se dikush do të mbronte interesat e tyre themelore. Thuhet se shpresa tek njeriu vdes e fundit, mirëpo kaluan dhjetë vjet pas luftime ndërsa punëtorët nuk u binden se me fatin e tyre nuk po merrej askush. Fatkeqësia e tyre tashmë po shfrytëzohej për pasurimin e atyre që më së paku ishin hisedarë në ndërmarrjet e ngritura ekonomike të Kosovës me dekada.

Dikush që kishte kurdisur (dhe kështu ndodhi në shumicën e rasteve) blerjen e cilësdo ndërmarrje filloi shitjen e pasurisë tokësore dhe me pak sipërfaqe të shitura në bazë të çmimeve të tregut nuk e hetoi blerjen. Në iks raste ndërmarrjeve të privatizuara iu ndërrua destinimi. Shumë halla fabrikash u bënë depo, mija hektarë toke buke që u shiten me çmime qesharake edhe 50 cent për një ari nga titullarët e rinj vazhduan të shiten për troje ndërtimi nga 5 mijë deri dhjetë mijë Euro siç është rasti në Miradi, Fushë Kosovë, në Rajonin e Pejës apo gjetiu. Pati shumë reklamë nga mediat për procesin e privatizimit por pa kaluar pak vjet edhe ata pak punëtorë që patën fatin të mbesin në vijat e prodhimit tashmë humben përfundimisht vendet e punës. Protestat e fundit të punëtorëve të Ballkanit të Therrandës dhe ato të Llamkosit të Vushtrrisë e dëshmojnë këtë më së miri.

Fati i ndërmarrjeve publike

Fati i ndërmarrjeve publike doli të jetë edhe më tragjik për punëtorë por i lehtë për manipulime. Bordet drejtuese të tyre u zgjodhën sipas dëshirave të njerëzve të caktuar dhe zakonisht kishin ngjyrat e partive në pushtet. Meqenëse ndërmarrjet publike si KEK-u, PTK, Aeroporti i Prishtinës kishin mjaft punë në situatën e krijuar dhe siguronin të ardhura kesh nga xhepi qytetar ato vepruan jo si ndërmarrje publike po më tepër si private. Nuk do koment se çka ngjau në KEK apo PTK. Kah u tretën milionat. Dhe gjithçka shkoi në dëm të qytetarëve të cilët paranë e tyre e panë zakonisht të investuar për llogari private. Askush, asnjëherë nuk i dha llogari askujt se ku u tretën milionat e PTK-së. Sa investime gëlltiti KEK-u për të mos mundur asnjëherë për dhjetë vjet të prodhojë dritë të mjaftueshme për Kosovën. Afër 800 milion Euro gëlltiti Korporata jonë energjetike për të mbetur jo vetëm qytetari ynë i stepur por edhe vetë Komisionari i lartë për politikë të jashtme

i BE-së. Nga u tretën të gjitha ato mjete e dinë të gjithë ata që për këto dhjetë vjet menaxhuan për xhepat e tyre këtë gjigant energjetik. Me Aeroportin e vetëm të Kosovës menaxhuan lloj-lloj drejtuesish për të ardhur në përfundim se nga ky subjekt me më shumë se një milion udhëtarë në vit mund të përfitohet mirë. Po këtu ka aq shumë marifete sa e vetmja iniciativë që dëgjohej është dhënia me koncesion e aeroportit që sjell të ardhura të pastra milionëshe.

Dështimet e mëdha të privatizimit

Çka është edhe më tragjike në Kosovë u privatizuan edhe një numër stacionesh të autobusëve. Madje në raste të caktuara pati edhe krekosje të pushtetarëve për një privatizim të tillë. Shtrohej pyetja se kur do të privatizoheshin edhe stacionet e trenave. Dikush nga faktori i jashtëm duket se tërhoqi vërejtjen dhe kjo marri tash për tash ka pushuar. Shtrohet pyetja e thjeshtë: nëse vazhdon ky trend privatizimi si do të dukej shteti ynë? Do kishte parë dikush diçka të tillë diku në botë? Kur mungon çfarëdo iniciative për të ndryshuar diçka, kur padronët ua lexuan punëtorëve letrat në xhep pa i hapur fare s'kishte si të ndodhë ndryshe. Punëtorët tanë nuk e merituan trajtimin përbuzës që vazhdoi gjatë një dekade pas luftime. Ishin sa duhet të ngritur punëtorët tanë dhe të përgatitur për sfidat e mëdha të kohës? Pse u keqpërdorën aq rëndë ata, në të gjitha periudhat e zhvillimeve shoqërore historike dhe fatale për Kosovën? Pse besuan si të verbër dhe heshtën tash e dhjetë vjet pas luftime? Kush manipuloi me ta për shkaqe krejt primitive? Kush nënshkroi kapitullimin e punëtorëve tanë? Si u keqpërdorën të gjitha donacionet që i erdhën BSPK-së pas luftime për aktivitetet sindikale? Pse nuk doli edhe një njeri i vetëm të konfrontohet me AKM-në ndaj shumë keqpërdorimeve dhe veprimeve jo parimore dhe veçanërisht ndaj Rregullores së privatizimit e cila definitivisht asgjësoi çdo shpresë për një vend pune? Punëtorët tanë nuk kanë merituar një trajtim të tillë.

Kishte dikur Kosova një shtresë mjaft të përgatitur punëtorësh në të gjithë lëmenjtë e ekonomisë dhe industrisë. Kishte krijuar një bazament profesional për punë të suksesshme në shumë degë të prodhimit. Punëtorët e Kosovës të shtypur me dekada, në një moment si edhe vetë Kosova me popullin e saj u gjendën përball pushtuesit. Asnjëherë punëtorët e Kosovës nuk janë përballur më rëndë me pushtuesin sesa në vitet '80 dhe '90 kur duke mos u pajtuar me pushtimin tipik fashist, ata, të larguar me dhunë nga vendet e punës nuk u hutuan për asnjë çast dhe ia dolën gjatë katastrofës më të madhe, për të humbur dhe për t'ua dorëzuar në kohën kur Kosova është e lirë. Rrezikuan jetën duke humbur punën po nuk u dorëzuan të koritur. Liria ishte më e çmueshme për ta. Sa miniera e minatorë, luanë të vërtetë të nëntokës i lanë kompresorët dhe lopatat për të mos

prodhuar për pushtuesin. Rrezikuan ata edhe mungesën e bukës për fëmijët e tyre, po liria ishte më e shtrenjtë. Vetëm Miniera e Treçës me Kishnicë e Novobërdë kishin dëshmuar se kur minatorët tanë lënë punën nuk është mirë për armikun. Ashtu edhe ndodhi. Prodhimi për armikun kishte rënë në pikën zero. Për propagandë shumë herë pushtuesi do të digjte goma në shkretore për të propaganduar se po prodhohej, po shumë shpejtë akti i minatorëve tanë po jepte rezultate.

Ku janë sot minatorët tanë? Kolona e tyre që kishte ngritur Evropën në këmbë tani është më shumë se e përgjysmuar. Një numër simbolik i tyre punon sa për të thënë, ndërsa shumë të tjerë marrin "pensione" qesharake. Sheh dikush minatorin tonë sot? Dëshmitar jemi të gjithë për pozitën e mjerë për keqardhje të tyre. A e merituan një trajtim të tillë minatorët këtë e dinë të gjithë pushtetarët e pasluftës në Kosovë. Dihet shumë mirë pse minierat nuk u aktivizuan asnjëherë. Çka ndodhi me ndërmarrjet shoqërore, me industrinë shumë të zhvilluar të tekstilit, me kompleksin agroindustrial, me industrinë e përpunimit të metaleve, me industrinë e materialit ndërtimor? A fitoi kush nga privatizimi i këtyre ndërmarrjeve? Gjithçka u shiti e u tret si më zi. Gjithçka u privatizua në formën "Kosova rabat". Ndodhi që në Kosovë nga privatizimi i të gjitha ndërmarrjeve shoqërore të të gjitha fushave të ekonomisë dhe industrisë të merren aq mjete sa vetëm nga shitja e një fabrike mesatare në Serbi. Nuk i munguan ekspertët Kosovës por dikush deshi që me procesin e privatizimit të përfitojnë individ të caktuar dhe të shuhet çdo ide e mëkëmbjes ekonomike të vendit. Goditje vdekjeprurëse nga privatizimi mori njëra nga shtyllat themelore të ekonomisë sonë - Agrokompleksi kosovar. Sot nga një gjigant i dikurshëm nuk ka mbetur edhe vetëm një hektar toke. Mund të dëgjosh se si nëpër shumë komuna të Kosovës mungojnë sipërfaqet e tokës publike dhe në shumë raste nuk mund të ndërtohen as objektet më të nevojshme të infrastrukturës, siç janë shkollat. Një fakt i tillë mund të konfirmohet në dritën e diellit, edhe në vet kryeqytetin tonë. Nga faktet e panumërta mund të konstatohet se askush nga ata që sot janë bartës të pushtetit nuk kanë as edhe një shkronjë plani zhvillimor për të ardhmen. Klasës politike, pa përjashtim, i mungon çfarëdo vizioni për zhvillimin e vendit. E gjithë energjia derdhët në deklarata apo synime për liberalizimin e vizave. Perspektiva e brezit të ri nuk shihet gjëkund.

Pak rreze shprese

Krahasuar me numrin e punëtorëve të punë në Kosovë dhe të atyre që në vazhdimësi po humbin punën nga privatizimi i dështuar, në firmat e vogla shumë pak njerëz kanë fatin të kenë gjetur një vend pune për faqe të bardhë. Ka edhe firma të suksesshme që afarojnë për lakmi dhe që do të duhej të stimuloheshin nga pushteti mirëpo ato ende ballafaqohen me kufizime e taksa nga më të ndryshmet.

(vazhdon në faqen

Komploti ndaj KEK-ut

Ekipet e "ekspertëve" të BE-së dhe USAID-it, dështimet e tyre të njëpasnjëshme, korrupsioni ndërkombëtarë me ko-produksion vendor, fitimet marramendëse që do t'i sillte një investim 3 miliardë dollarësh për investitorët e huaj dhe pushtetarët e korruptuar, të gjitha këto më shumë sesa rregullimin e situatës me rrymën elektrike kanë pasur për qëllim dëshmimin e pamundësisë së rregullimit të saj në mënyrë që ndërtimin e Kosovës C ta kërkojmë vetë ne, qytetarët e këtij vendi.

Mbi 1.1 miliard euro deri me tash janë futur në ndërmarrjen publike, Korporatën Energjetike të Kosovës, ndërkohë që edhe dhjetë vite pas nuk është bërë asnjë raport me detaje se ku janë shpenzuar këto të holla. Jo vetëm paratë e donatorëve të jashtëm por as ato që vite me radhë janë dhënë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, nuk kanë asnjë "faturë" të publikuar për adresën e shpenzimeve. Kurse kërkesat për investime nga jashtë vazhdojnë të mbesin opsioni i

vetëm. Edhe pse situata energjetike nuk ka ndryshuar, të gjitha Qeveritë këto dhjetë vjetët e fundit kanë pasur qëndrim të njëjtë karshi kësaj ndërmarrje publike, me të vetmin qëllim shkatërrimin e saj me planet për të përfituar grupe të caktuara nga kjo situatë.

"Coptimi" i KEK-ut

Planet për ndarjen e KEK-ut kanë nisur gjashtë vjet më parë kur doli edhe ideja e pa dëgjuar më herët se do ti bëhet "Unbundeling" kësaj ndërmarrje. Të gjithë pyesnin se çfarë do të ndodh me këtë procedurë të re, derisa u tha se do të bëhet shthurje e KEK-ut në mënyrë që të stabilizohet situata energjetike.

Ky doli të jetë plani më i mirë për t'u përfshirë në konflikt të ashpër të interesit ndërkombëtarët që menaxhonin me KEK-un dhe zyrtarët vendor me ata qeveritar. Duke filluar me ndarje, mos hapje të mihjes së re të Sibovcit, blerjen e energjisë me kontrata afatshkurta dhe çmime shumë të larta, e kanë sjellë KEK-un në gjendje para bankrotimit duke i lënë hapësirë arsytetimeve se neve na duhet një investitor privat për të na nxjerr nga terri. KEK-u me vite me radhë është bërë shënjestër e njerëzve që kanë përfaqësuar interesa private në treg duke i bërë nder konkurrentëve të energjisë në treg, ndërkohë që nga KEK-u nuk kanë lënë të pritët shumë. Kështu që doli edhe projekti "Kosova C".

Ky komplot është organizuar haptazi nga individë të caktuar me ndihmën e këshilltarëve të huaj dhe zyrtarëve të

Qeverive. KEK-u dhe ndërmarrjet tjera publike edhe pse dikur kanë qenë bazë për ekonominë e këtij vendi, sot është marrë vendimi që ato të privatizohen. Anomalia qëndron në faktin se ende nuk kanë bërë asnjë vlerësim të tyre që të paktën nga shitja e tyre të përfitojë diçka Kosova, ndërkohë që vet zyrtarët e Qeverisë thonë se ato nuk do të shiten me çmimet e tregut. Përfundimisht bëhet e qartë se nuk ka një vullnet politik në qeveri për t'i mbrojtur ato.

Ministri për Ekonomi dhe Financa, Ahmet Shala ka bërë të ditur se Korporata Energjetike e Kosovës do të hyjë shumë shpejt në privatizim dhe sektori i parë që do të privatizohet do të jetë ai i distribuimit të energjisë elektrike. Sipas kësaj Qeveria kjo është parë si e vetmja mundësi për t'u furnizuar më mirë me energji. Pasi që ka thithur mbi 1.1 miliard euro, del sugjerimi që me shitjen e kësaj pjese të KEK-ut do të stabilizohet gjendja energjetike. Duke e pasur parasysh se deri me tash nuk ka pasur investime në këtë sektor dhe se borxhet vazhdojnë të mbesin të larta, nga shitja e tij nuk pritët të përfitoj diçka buxheti i Kosovës. Ndërkohë Qeveria e ka mbështetur kërkesën e MEF-it që të formohet një komision për verifikimin e procesit të privatizimit të këtij sektori energjetik dhe tashmë punët për shkatërrimin përfundimtar të KEK-ut kanë nisur.

Shitjen e distribuimit, kjo qeveri e ka marrë me aq nguti sa që ende pa u miratuar në Kuvendin e Kosovës ligji për ndarjen e korporatës, kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi e ka hedh në votim kërkesën për privatizim. Arsyetimi banal është dhënë se në këtë

mënyrë do të ketë stabilizim të kësaj ndërmarrje me vetëqëndrueshmëri të plotë, ndërkohë që plani i cili është duke u realizuar tregon për mbylljen e kësaj ndërmarrje më ndërtimin e termocentralit të ri mbi 2000 megavatësh me kapital privat. Mirëpo, qëllimi i Qeverisë është që me këtë shitje të distribuimit të KEK-ut t'i shërbejë investitorit privat i cili do ta ndërtoj termocentralin e ri.

Vet kryeministri i Kosovës është shprehur se privatizimi i distribuimit të KEK-ut do të shërbejë si tregim suksesi për përfshirjen e kapitalit privat në zhvillimin e sektorit energjetik dhe do të mundësojë investime private në minierat dhe gjenerim, përfshirë këtu edhe zhvillimin e projektit të rëndësishëm të Kosovës C. Mirëpo, situata në KEK tregon që kjo ndërmarrje është shumë larg situatës së favorshme për privatizim. Sipas kërkesave që dalin nga Traktati i Athinës, Korporata Energjetike e Kosovës në kuadër të ristrukturimit të sektorit të energjisë në Evropë përkatësisht në Evropën Juglindore, është dashur të përfundojë së pari shthurjen apo inkuorporimin e pastaj të shkojë drejt privatizimit të departamenteve të tij. Më pas me shthurje përveç ndarjes së llogarive financiare departamentet e KEK-ut si ai i gjenerimit, mihjeve, dhe distribuicioni do të mund të bënin edhe ndarjen e plotë të aseteve. Departamentet e KEK-ut pas inkuorporimit do të ishin kontraktuese të shërbimeve mes vete. Ato më pas do të funksiononin me buxhet të ndarë, por secili nga departamentet do të ishte në gjendje të caktoj shpenzimet e veta të cilat shprehin koston e tyre të aprovuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

(vazhdon në faqen tjetër)

(vazhdon nga faqja e kaluar)

Nëse dikur, jo fort moti, nga puna u nxorën me dhunë mbi 200 mijë punëtorë shqiptarë, sipas trendeve të tashme të ekonomisë sonë do të duhej të kalonin edhe dyqind vjet që të kemi në prodhim një shifër të tillë punëtorësh. Të gjitha këto shënime më së miri i dëshmon raporti eksport - import i Kosovës. Kuadrot e përgatitura mirë vazhdimisht largohen nga Kosova në forma të ndryshme në mungesë të çfarëdo perspektive. Një student shembullor që ka mbaruar mjekësinë ka të vetmen shpresë pasaportën dhe një vizë fals për të udhëtuar drejt botës për një vend pune, qoftë edhe të kamerierit. Pak fusha pune mund të hasësh në Kosovë. Derisa ekspertët shëndetësorë kanë përlllogaritur se Kosova me trendet e tashme të shkollimit të mjekëve nuk do të mund të plotësojë nevojat e saj për kujdesin primar edhe 17 vjet të ardhshme, pas lufte mund të gesh më shumë se 200 mjekë të papunë apo duke punuar punë tjetër sekondare, jo të profesionit.

Për të bindur të gjithë ata që sot përpiqen të shesin mjegull, faktet për gjendjen e ekonomisë së Kosovës flasin në çdo hap. Mjafton të krahasosh eksportin e prodhimit me import. Mjafton edhe të thuhet e vërteta se çka eksporton Kosova. Mjafton të vizitosh secilin komunë dhe secilin ent a departament të evidencimit të punëtorëve, kudo në Kosovë. Mjafton të vizitosh një ditë ndonjërin nga përfaqësuesit e huaja diplomatike në Kosovë. Numri i punëtorëve, të rinjve por edhe i atyre që kërkojnë një vizë për të ikur është tronditës. Në mungesë të ligjit të punës, shumë vende pune në të gjithë sektorët e veprimtarive publike vazhdojnë të dërgjen edhe invalid e të paftë për cilëndo punë. Ata shkojnë me zor në vend pune, vetëm sa për të thënë, ndërsa brezi i ri, i kualifikuar kërkon vizë për të ikur. Në arsim, në shëndetësi, në administratë, në polici e gjetkë, të sëmureve, të paftë për punë duhet t'u gjendet zgjidhja. Në këto fusha mbahen pa efekt shumë vende pune. Pushtetarët aktual duhet të japin përgjigje pse mjetet e grumbulluara nga privatizimi mbahen jashtë, sa është shuma e tyre e saktë? Kush po përfiton nga afatizimi i tyre dhe pse ato nuk i kthehen vendit? Çka po ndodh me mjetet e Trustit Pensional e Invalidor të Kosovës dhe kur punëtorët tanë do të mund të shpresojnë se të drejtat e tyre i mbron ligji. Shpresat për lëvizje të lirë drejt Evropës mund të bëhen reale vetëm atëherë kur edhe praktikisht bindim miqtë tanë se shteti ligjor po funksionon. Për këtë nuk ka nevojë të shkojmë në Bruksel e as në Strasburg. Evropa tashmë është tek ne. Të gjithë po na shohin. Në këtë drejtim nuk ka nevojë për lobim politik. Shteti funksional i demanton të gjithë armiqtë.



(vazhdon nga faqja e kaluar)

Edhe kjo ide ka të bëjë me hapjen e rrugës për investime me kapital privat. Shturja e KEK-ut është dashur të përfundojë në qershor të vitit 2007, deri më tani vetëm Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, KOSTT, është njësia e parë dhe e vetme e ndarë nga KEK-u në vitin 2006.

Paratë e gëlltitura dhe përgatitja e terrenit për investitorin e huaj

Që nga përfundimi i luftës në vitin 1999 vetëm Bashkimi Evropian ka dhënë rreth 400 milion euro për sektorin e energjisë elektrike në Kosovë përmes Agjencisë Evropiane për Rindërtim, EAR. Qeveria e Kosovës ka shpenzuar mbi 400 milion euro dhe dhjetëra e qindra miliona të tjera janë ndarë nga donatorë të tjerë. Disa donatorë kanë bërë të ditur se paratë e tyre janë përdorur për importim të energjisë, ndërkohë që shumë të tjerë vlerësojnë se paratë e tyre

janë shpenzuar për riparime të termocentraleve të KEK-ut. Ndërkohë që vet zyrtarët e KEK-ut kanë konfirmuar disa herë se ata kanë pranuar donacione nga donatorë por që nuk e dinë saktë se sa të holla ishin pranuar dhe se si janë shpenzuar ato. Arsyetimet për mos mbajtjen e saktë të evidencave për paratë që janë dhënë për KEK-un janë mbështetur në ndryshimet e shpeshta në udhëheqësinë e KEK-ut. Kompania ka pasur pesë drejtorë ndërkombëtar menaxhues që nga viti 1999, përfshirë edhe kompaninë ESI të Irlandës të cilët me të kthyer në vendin e vet kanë marrë miliona euro ne emër të kontratës që kanë nënshkruar me menaxhmentin e KEK-ut si ekspertë të energjetikës. Ndërkohë që pagat dhe shpenzimet e larta në emër të "ndërmarrjes së shtetit" nuk janë zvogëluar as nga menaxhmenti vendor.

Si pasojë e mosmenaxhimit adekuat të kësaj ndërmarrje dhe shkatërrimit të saj dalin sug-

jerimet nga institucionet e rëndësishme financiare siç është Banka Botërore se investimet e nevojitura për të rehabilituar elektranat energjike të tanishme apo për të ndërtuar të reja janë aq të larta se që shpenzimet kalojnë kapacitetin e donatorëve dhe qeverisë së Kosovës. Kështu që BB-ja ka deklaruar se e vetmja shpresë qëndron në sektorin privat. Në këtë mënyrë po bëhet e qartë se këtu ka pasur një plan për shkatërrimin e qëllimshëm të KEK-ut, apo degradimin e tij deri në atë masë sa ndërtimi i termocentralit të ri të na paraqitet si i domosdoshëm. Ekspertët e "ekspertëve" të BE-së dhe USAID-it, dështimet e tyre të njëpasnjëshme, korrupsioni ndërkombëtarë me ko-produksion vendor, fitimet marrazmendëse që do t'i sillte një investim 3 miliardë dollarësh për investitorët e huaj dhe pushtetarët e korruptuar, të gjitha këto më shumë sesa rregullimin e situatës me rrymën elektrike kanë pasur për qëllim dëshmimin e pamundësisë së rregullimit të saj

në mënyrë që ndërtimin e Kosovës C ta kërkojmë vetë ne, qytetarët e këtij vendi.

Por Kosova C më së paku po ndërtohet për qytetarët e Kosovës (parë nga perspektiva e investitorit të jashtëm, s' do mend kjo punë). Vet zyrtarët e Bankës Botërore kanë bërë të ditur në prezantimet e tyre për energjetikën për përfitimet që do t'i ketë rajoni nga thëngjilli i Kosovës. Sipas tyre në njëzet vitet e ardhshme një pjesë e madhe e Evropës Juglindore do të furnizohet me thëngjillin e Kosovës. Është thënë disa herë se ndërtimi i termocentralit të ri me mbi 2000 megavat orë energji elektrike do të jetë edhe për furnizimin e vendeve të tjera me energji elektrike. Një investim mbi tre miliardë dollarësh nuk do t'i shpaguej investitorit të huaj në tregun e vogël të Kosovës prandaj ai kërkon treg më të gjerë, rajonal. Kjo i bie që në dyzet vitet e ardhshme investori i huaj do të fitojë duke ia shitur qymyrin tonë vendeve të rajonit.

Sibovci

Por kjo nuk është e tëra. Mihja e Sibovcit e cila përmban thëngjill edhe për rreth pesëdhjetë vitet e ardhshme ka bërë që të gjithë t'ia mësyjnë për të përfituar sa më shumë nga ajo. Ndërkohë që mosmarrëveshjet mes grupeve të caktuara të interesit kanë bërë që ajo të mbetet e bllokuar, të mos hapet për një kohë të gjatë duke e lënë edhe KEK-un pa thëngjill duke e pasur parasysh se mihjet ekzistuese të Bardhit dhe të Mirashit me të cilat furnizohet KEK-u me thëngjill janë shterur.

Dy qeveritë e fundit i kanë dhënë më shumë përparësi investitorit privat që të përfitojë nga kjo mihje sesa vet Kosovës. Është marrë vendimi që investori i cili do të ndërtojë termocentralin e ri të furnizohet me thëngjill për dekada me radhë nga kjo mihje. Duke ia dhënë mihjen e Sibovcit investitorit të huaj, paradoksalisht, ne do ta blejmë qymyrin tonë nga ai.

Organizata ÇOHU!

Modeli ka dështuar, të tjerat kanë pak rëndësi

"Diçka e tillë ne ende nuk na bën përshtypje, sepse jetojmë ende nën iluzionin se Shqipëria do ta zhvillojë investimet e huaja, një ide kjo sa qesharake aq edhe e pavërtetë, pasi edhe në vendet me nivelin më të lartë të investimit të huaj si Kina motori i zhvillimit është kapitali lokal dhe jo thjesht ai ndërkombëtar. Investitori i huaj kërkon thjesht krahë të lirë pune, stabilitet politik dhe ekonomik që fitimet e investimit që nxjerr në vende si Shqipëria t'i nxjerrë lirshëm edhe jashtë Shqipërisë."

Blendi KAJSIU
(Marrë nga Panorama online)

Një pikë ku të gjitha palët në vendin tonë bashkohen është ideja se problemi në Shqipëri nuk është me modelin aktual politik-ekonomik, por me moszbatimin rigoroz të tij. Konsensusi në këtë pikë është aq i gjerë saqë ideja se mosfunksionimi i sistemit mund të jetë pasojë e vetë sistemit as nuk shtrohet për diskutim. Pikërisht ky është edhe argumenti bazë i këtij artikulli. Dështimi i modelit politik-ekonomik që qeveritë shqiptare kanë ndjekur këto dy dekadat e fundit me rekomandimin dhe nën mbikëqyrjen e ndërkombëtarëve buron nga vetë modeli. Problemi me modelin aktual nuk buron nga moszbatimi por nga vetë përpjekja për ta zbatuar atë. Problemi nuk është se institucionet tona shtetërore janë të dobëta, por se ato janë dobësuar nga vetë modeli politik-ekonomik që kanë realizuar në praktikë. Problemi nuk është se politikanëve tanë u mungon vullneti për të zbatuar modelin politik-ekonomik, që na rekomandojnë organizma si BE-ja apo institucione si FMN dhe Banka Botërore, por tek përpjekja e pareshtur e tyre për ta zbatuar atë.

Në këtë pikë më duhet të sqaroj për çfarë modeli bëhet fjalë. Politikisht ky model nënkupton një demokraci pluraliste sipas modelit që ofron Robert Dahl në një nga librat më të mërzuar të literaturës mbi demokracinë Poliarkia. Është një demokraci kryesisht procedurale, që përcaktohet nga ekzistenca e pozitës dhe opozitës, nga zgjedhje të lira dhe të ndershme dhe grupe të ndryshme interesi që konkurro-

jnë për të influencuar pushtetin. Ky është në thelb modeli politik që mund të duket i thjeshtë për faktin e thjeshtë se është vërtet i tillë dhe ndoshta prandaj dhe përqafohet kaq lehtë. Modeli ekonomik nga ana tjetër ka në thelb atë që quhet konsensusi i Uashingtonit. Në qendër të modelit është tregu si burim zhvillimi dhe në funksion të së cilit vendoset shteti, roli i të cilit reduktohet te garantimi i sistemit të drejtësisë dhe rendit, të domosdoshëm për të garantuar pronën private. Prioritet ka stabiliteti makro-ekonomik që në thelb do të thotë politikë monetariste që lufton inflacionin dhe reduktim të deficitit buxhetor. Institucione si Banka Qendrore apo sistemi bankar janë nxjerrë jashtë kontrollit shtetëror. Tregu lokal nga ana tjetër duhet të jetë i hapur ndaj tregut ndërkombëtar, pra të mos ketë masa proteksioniste dhe të mirëpresë dhe t'i përshtatet investitorëve të huaj. Është e rëndësishme të theksojmë se kemi të bëjmë me një model jo vetëm politik, por edhe ekonomik pasi fatkeqësisht analizat lokale dhe ndërkombëtare ndalen vetëm tek dimensionin politik dhe injorojnë atë ekonomik, a thua se një sistem politik ekziston në ajër. Prandaj për të kuptuar dështimet e sistemit tonë politik duhet të fillojmë nga ku burojnë edhe dështimet e sistemit politik.

Dështimi i modelit tonë ekonomik të zhvillimit është shumë i lehtë për t'u kuptuar nga vetë dështimi i ekonomisë sonë. Ekonomisë sonë i mungon pothuajse tërësisht një sektor prodhues dhe aq më tepër një sektor prodhues konkurrues, çka vë në pikëpyetje integritetin e ekonomisë shqiptare në tregjet globale. E thënë thjesht ekonomikisht sonë i mungon një

motor zhvillimi. Për të kuptuar këtë mjafton të përpiqemi ti përgjigjemi pyetjes: me çfarë konkurron Shqipëria sot pas 20 vitesh tranzicion në tregun rajonal? Po atë global? Për momentin ne konkurrojmë me kanabis, heroinë, kokainë, dhe prostitucion si në tregjet rajonale edhe ato evropiane. Këto janë produktet Made in Albania, për të cilat ne njihemi më shumë sot në botë. Dhe kjo për faktin se nuk jemi të aftë të konkurrojmë me produkte të tjera. Po përse pas pothuajse dy dekadash tranzicion ekonomia jonë nuk konkurron jo më në tregun evropian por as në atë rajonal? Arsyet mund të përmbledhen tek katër elementët thelbësor të modelit tonë ekonomik të zhvillimit; tregtia e lirë, tërheqja e shtetit, stabiliteti makro-ekonomik dhe investimet e huaja si prioritet.

Së pari, tregtia e lirë do të thotë pamundësia për të mbrojtur produktet apo ekonominë vendase, kapitalin, prodhuesit dhe biznesin vendas. Dhe nëse ky sektor shpartalohet që në lindje nga konkurrenca që vjen nga jashtë është e kotë të presësh që një ditë ai do lindë i rritur për të konkurruar në tregjet globale. Le të marrim rastin e bujqësisë që tashmë është e qartë që është në gjendje katastrofale. Është alogjike të mendosh që produktet tona bujqësore të mund të konkurrojnë në tregun e lirë me ato të Greqisë apo BE-së, sidomos po të kemi parasysh që BE me politika të tipit Common Agricultural Policy (CAP) e mbron dhe e subvencionon bujqësinë e saj. Prandaj dështimi i vazhdueshëm i bujqësisë sonë përpara, se sa të kërkohet tek problemi i pronësisë në fshat duhet kërkuar tek konkurrenca që vjen nga jashtë. Produktet tona bujqësore nuk

kanë treg sepse edhe tregu ynë i brendshëm është hapur totalisht ndaj produkteve që vijnë nga jashtë. Sikur të mos ishte korrupsioni apo zvarritjet në dogana që e reduktojnë deri diku tregtinë e lirë bujqësia jonë do ishte akoma edhe më rëndë. Kështu në rastin e bujqësisë tregtia e lirë krijon një rreth vicioz, ku fillimisht shkatërohet prodhimi vendas, në mungesë të mbështetjes sociale nga shteti kjo prodhon emigrim të krahut më të aftë të punës në bujqësi drejt vendeve si Greqia ku ky krah shfrytëzohet deri në palcë për të forcuar bujqësinë greke, që më pas konkurron edhe më shumë bujqësinë shqiptare që për pasojë prodhon edhe më shumë emigracion edhe më pak produkte bujqësore.

Së dyti, efekti negativ i tregtisë së lirë kombinohet me efektin negativ që prodhon reduktimi i politikave zhvillimore tek stabiliteti makro-ekonomik, lufta ndaj inflacionit dhe kontrolli i deficitit buxhetor. Natyrisht që stabiliteti makro-ekonomik është pozitiv, por nuk mund të jetë qëllim në vetvete, qëllim është zhvillimi i ekonomisë vendase. Përndryshe përfundojmë aty ku jemi sot - një vend i varfër në prodhim dhe zhvillim por i pasur në stabilitet makro-ekonomik. Në thelb ky stabilitet ka nënkuptuar së pari reduktimin e mundësisë së subvencionimit të produktit vendas, pasi kjo do të prodhonte deficit buxhetor. Stabiliteti makro-ekonomik si prioritet ka nënkuptuar edhe pavarësinë e sistemit bankar nga kontrolli shtetëror, duke filluar me Bankën Qendrore. Duke qenë të pavarura, institucione të tilla mund të garantojnë më mirë stabilitetin e monedhës, apo reduktimin e inflacionit që përndryshe mund të dilte jashtë kontrollit nga papërgjegjshmëria

e qeverisë sidomos gjatë fushatave elektorale. Natyrisht që një logjikë e tillë nuk është e pabazë, pasi qeveritë shpesh abuzojnë me shpenzimet dhe kanë tendencë ta financojnë deficitet me zhvlerësim të monedhës, pra duke shkaktuar inflacion. Ama nxjerrja e institucioneve kryesore financiare jashtë kontrollit shtetëror prodhon një sektor financiar, që e vështirëson financimin e sipërmarrjes vendase, duke nxjerrë shtetin jashtë loje si promotor zhvillimi. Kemi ardhur pra tek faktori i tretë, tërheqja e shtetit. Pasoja negative të kësaj tërheqjeje në shoqëri shfaqen tek pabarazia në rritje dhe tek trauma që shkakton mungesa e politikave sociale për individët dhe komunitetet e marginalizuara. Ndërsa në ekonomi efekti negativ i tërheqjes së shtetit duket më qartë se kudo tek financimi i dobët i kapitalit dhe sipërmarrjes vendase. Ne sot kemi një sektor shumë të suksesshëm bankar, të pavarur nga shteti dhe me një Bankë Qendrore që ka arritur të kontrollojë inflacionin. Ama ajo që ne nuk kemi sot është një financim të mirë të sipërmarrjes dhe kapitalit vendas. E thënë thjesht kapitali dhe sipërmarrja lokale në Shqipëri e ka të vështirë të marrë financim apo likuiditet nga sektori financiar sidomos në fazat e para të zhvillimit. Interesat e larta që bankat i ofrojnë sot sipërmarrjes shqiptare e vdesin atë pa lindur mirë. Aq më tepër në kushtet kur kjo sipërmarrje nuk ka treg të garantuar si pasojë e tregtisë së lirë. Kjo shpjegon edhe 'shëndetin' e bankave tona që nuk vuajnë mungesën e likuiditetit në kulmin e një krize likuiditeti të biznesit lokal.

(vazhdon në faqen tjetër)

(vazhdon nga faqja e kaluar)

Marrëdhënia e ngushtë, e koordinuar dhe e garantuar mes sektorit financiar dhe sipërmarrjes është edhe një nga kushtet themelore të bumit ekonomik. Mungesa e kreditimit të butë dhe afatgjatë penalizon mbi të gjitha sipërmarrjet e suksesshme pasi si pasojë e ekspansionit ato janë më të eturat për financim. Eksperienca e historive të suksesit ekonomik të Tigrave Aziatik, Japonisë apo Kinës tregon para së gjithash përdorimin e sektorit financiar në funksion të kapitalit dhe sipërmarrjes vendase. Në rastin e Kinës ky sektor është në pronësi të shtetit dhe për pasojë i ofron financime bujare sipërmarrjeve vendase, duke pasur prioritet nevojat e këtij sektori edhe me garancitë që i ofron qeveria për kreditë problematike. Përkundër kësaj eksperience në Shqipëri prioritet është thjesht tërheqja e investimeve të huaja dhe jo forcimi i kapitalit lokal, çka mund të arrihej edhe me stimulimin në investimet me pjesëmarrje të përbashkët të kapitalit të huaj me atë vendas në mënyrë që të forcohet ky i dyti.

Kemi arritur pra tek faktori i katërt; investimet e huaja si prioritet. Modeli aktual prioritet i jep investimeve të huaja dhe jo atyre lokale. Për këtë arsye edhe sot pas njëzet vitesh, pas miliarda eurove që shqiptarët me punën e tyre kanë sjellë në Shqipëri aktorët dhe përfituesit kryesor të ekonomisë sonë janë investitorët e huaj dhe jo sipërmarrja lokale. Kështu që shumë sesa zhvillimin e sipërmarrjes shqiptare në botë modeli aktual garanton zhvillimin e kapitalit global në Shqipëri. Kapitali i huaj, sektorët e telefonisë celulare dhe të sistemit bankar janë më fitimprurësit sot për sot në ekonominë shqiptare. Po t'i besojmë kryeministrit në të ardhmen kapitali i huaj do ta shfrytëzojë akoma më shumë Shqipërinë për të ndërtuar tece me gymyr ku do prodhohet energji që do të zhvillojë së pari ekonominë e origjinës. Pra, ne sot kemi ngritur një ekonomi që kursimet e qytetarëve shqiptar nuk i kanalizojnë në forcimin e sipërmarrjes vendase. Paratë që këta fusin në Shqipëri prodhojnë një vlerë të shtuar të pakët sepse në një pjesë të mirë dalin përsëri jashtë saj nëpërmjet eksporteve ose thithen nga kapitalit të huaj. Diçka e tillë ne ende nuk na bën përshtypje, sepse jetojmë ende nën iluzionin se Shqipërinë do ta zhvillojnë

investimet e huaja, një ide kjo sa qesharake aq edhe e pavërtetë, pasi edhe në vendet me nivelin më të lartë të investimit të huaj si Kina motori i zhvillimit është kapitali lokal dhe jo thjesht ai ndërkombëtar. Investitori i huaj kërkon thjesht krahë të lirë pune, stabilitet politik dhe ekonomik që fitimet e investimit që nxjerr në vende si Shqipëria t'i nxjerrë lirshëm edhe jashtë Shqipërisë.

Ideali i një shteti të tërhequr nga shoqëria që thjesht garanton rendin, infrastrukturën dhe pronën është në fakt ideali i investitorit të huaj, që fatkeqësisht është kthyer edhe në idealin e politikës sonë dhe që për pasojë prodhon një vend me pabarazi në rritje, ku një grusht pasurohen dhe masa e gjerë me vështirësi mbijeton. Po a nuk do të krijonte pabarazi dhe varfëri edhe një shtet, që i bëhet krah sipërmarrjes dhe kapitalit lokal? A nuk do të krijonte ky model disa sipërmarrës dhe kapitalist të pasur shqiptar rrethuar nga një masë varfërie? Jo dhe jo, edhe pse rreziku ekziston. Nëse shteti ynë do e mbështeste realisht sipërmarrjen vendase, duke mbrojtur produktin lokal, duke i garantuar financim të bollshëm nëpërmjet kredive të buta, duke e orientuar me informacion në tregun rajonal dhe global, atëherë ky shtet do kishte edhe të drejtën edhe mundësinë që ta tatonte më shumë kapitalin vendas, i cili për më tepër do prodhonte vlerë të shtuar. Në këto kushte shteti ynë do kish mundësi edhe ti impononte kapitalit vendas kushte më të mira punësimi për punëtorët dhe komunitetet ku ata zhvillojnë aktivitetin e tyre, pra të garantonte një nivel më të lartë barazie në shoqëri. Pra nga njëra anë shteti i garanton fitim kapitalit vendas nga ana tjetër i merr atij një pjesë të mirë të këtij fitimi për ta rishpërndarë dhe për të financuar institucionet publike, spitalet, shkollat, etj. Kjo në fakt ka qenë edhe eksperienca e Tigrave të Azisë ku shteti në këtë mënyrë ka arritur të reduktojë pabarazinë sociale dhe gjeografike përgjatë një bumi ekonomik. Ky fakt duhet theksuar, sepse modeli ynë aktual i zhvillimit e shikon rritjen e pabarazisë si domosdoshmëri të zhvillimit ekonomik, gjë që empirikisht nuk është aspak e vërtetë për vende si Japonia apo edhe Korea e Jugut që kanë pasur zhvillim të jashtëzakonshëm ekonomik. Kemi të bëjmë me një qasje shumë më efikase sesa thjesht ulja e taksave, sepse edhe sikur ta çojmë taksën zero

sipërmarrja shqiptare nuk mund të zhvillohet vetvetiu për sa kohë nuk ka treg për të dhe financimin nga bankat e merr afatshkurtër dhe me interes të papërbalueshëm. Një sipërmarrësi më shumë sesa taksat e ulëta i intereson të ketë treg dhe financim të garantuar në mënyrë që të investojë. Natyrisht që ulja e taksave e ndihmon deri diku çdo biznes, por në mungesë të tregut dhe financimit efekti i kësaj ulje është i pakët madje në termin afatgjatë edhe negativ po të kemi parasysh se ulja e taksave që nuk shkakton ndonjë bum ekonomik redukton të ardhurat e buxhetit dhe për pasojë investimet publike, që nga infrastruktura deri tek institucionet shtetërore. Ulja e taksave mund të tërheqë ndonjë investitor të huaj më shumë, por që do të largohet përsëri sapo qeveria të rrisë taksat për të financuar shërbimet publike. Prandaj investimet e huaja në mungesë të sipërmarrjeve të fuqishme lokale përkthehen kollaj në zhvatje. Historitë e investimeve të huaja, që na shet qeveria sot në një masë të mirë janë shfrytëzim i territorit shqiptar më shumë se zhvillim i vendit tonë.

Këtu është e rëndësishme të kuptojmë rrethin vicioz ku ndodhemi. Faktorët e mësipërm, tregtia e lirë, përparësia ndaj kapitalit të huaj dhe jo atij lokal, organizimi i sistemit bankar që vështirëson financimin e kapitalit vendas, prioriteti anti-inflacion dhe objektivat e stabilitetit makroekonomik, tërheqja e shtetit dhe ulja e financimit për shërbimet publike dhe institucionet shtetërore, ndërveprojnë të gjithë njëkohësisht edhe pse janë trajtuar veç e veç për të lehtësuar analizën. Ndërveprimi i këtyre faktorëve prodhon një ekonomi tejet të dobët ku kapitali dhe sipërmarrja lokale nuk zhvillohen sepse janë të pambrojtura nga konkurrenca globale, të pafinancuara mjaftueshëm nga institucionet financiare dhe edhe të paorientuara nga politikat afatgjata shtetërore. Një ekonomi e dobët, apo pa motor zhvillimi prodhon një shtet të dobët që të ardhurat i përfiton kryesisht nga aktiviteti tregtar dhe jo prodhues, siç janë doganat, apo duke tatuar biznese që në tërësinë e tyre mezi mbahen. Dhe këtu problemi nuk është thjesht paaftësia e shtetit tonë për të mbledhur taksat. Ekonomia informale në Shqipëri është masive sepse një pjesë e mirë e sipërmarrjes vendase mund të mbijetojë vetëm në informalitet përndryshe

vdes, dhe kjo është një nga arsyet se përse suksesi i qeverisë aktuale në rritjen e formalitetit ekonomik ka prodhuar pakënaqësi. Kjo ekonomi e dobët nga ana tjetër prodhon një shtet të dobët, me administratë të dobët, me sektor publik si edukimi apo shëndetësia tejet të dobët nga mungesa e financimit, që mbi të gjitha ulin cilësinë e jetës sonë por i nxinë jetën edhe asaj sipërmarrje lokale që përpiqet të mbijetojë. Prandaj prioriteti i Shqipërisë sot nuk duhet të jetë forcimi i shtetit por një model alternativ zhvillimi. Edhe sikur teorikisht shteti ynë të forcohej, gjë që është e pamundur praktikisht, ai nuk do të gjenonte zhvillim ekonomik me modelin dhe politikat që ne ndjekim sot. Kjo sepse sipërmarrja shqiptare do ishte njësoj e pambrojtur dhe e pambshtetur financiarisht.

Nuk është e nevojshme të jesh Marksist për të kuptuar se nuk mund të ndërtohet një shtet të fortë me një ekonomi të dobët. Aq më pak mund të krijosh një sistem të shëndetshëm politik me një ekonomi që nuk prodhon zhvillim të qëndrueshëm, stimulon emigracionin, polarizimin social dhe gjeografik pasi i gjithë zhvillimi gjeografikisht përqendrohet në qendrat kryesore urbane, ndërsa shoqërisht në pak duar biznesmenësh lokal, sepse në fakt shumica e fitimit që prodhon ekonomia shqiptare del jashtë Shqipërisë. Një sistem i tillë ekonomik prodhon dy efekte shkatërruese për shoqërinë shqiptare. Në nivelin e elitës ekonomike konkurrenca mes grupeve politiko-mediato-biznesi bëhet tejet e ashpër, sepse burimet dhe fitimet që prodhon ekonomia shqiptare për sipërmarrjen lokale janë tejet të kufizuara. Në nivelin e popullatës varfëria që sistemi ynë ekonomik prodhon për masën e gjerë të qytetarëve do të thotë që qytetarët janë tejet të zënë me mbijetesën personale për të krijuar një komunitet të shëndetshëm politik. Kombinimi i këtyre dy faktorëve krijon një sistem politik me përplasje të ashpra mes individëve në nivel elitash politiko-biznesi nga njëra anë dhe një popullatë me ndjeshmëri të ulët të moralit publik pasi është në moment mbijetese. Për pasojë kemi një shkëputje të elitës nga masa e gjerë e popullatës që në mungesë të emigracionit do kish përfunduar në varfëri absolute. E thënë ndryshe politika bëhet thellësisht jo-përfunduese. Dhe ky është në thelb deformimi politik që prodhon modeli ynë ekonomik-politik i zhvillimit.

RFERL



Arroganca e kapitalizmit

Por, përveç në planin politik, cili është dëmi i madh ekonomik që Thaçi, si student i zellshëm i Ahtisaarit do t'i sjellë Kosovës? Privatizimi! Unë mendoj se privatizimi është rreziku më i madh politiko-ekonomik që i kanoset Kosovës. Duka Faith dhe Dukeshja Kaidanow na thonë se vetëm kështu mund të zhvillohemi ekonomikisht. Ne u themi në rregull, por pse mos ta luajmë lojën e njejtë së bashku: sikur ju në vendet e juaja të hiqni dorë nga nacionalizimi (ose blerja e aksioneve më të mëdha) të bankave që ose kanë falimentuar ose janë drejt falimentimit (si pasojë e krizës financiare) edhe ne do ta bëjmë të njejtën. Ata na thonë se nuk mund të funksionojmë jashtë kapitalizmit. Ne e aprovojmë këtë, sepse vërtetë është teze e saktë: por pse nuk i vendosim rregullat e njejtë të funksionimit të kapitalizmit?

Agon HAMZA

Zjedhjet e fundit në Kosovë ishin dëshmia më e pastër se si funksionon koncepti i demokracisë liberale. Raporti ndërmjet "të gjithëve" dhe "jo të gjithëve" funksionoi në mënyrën më të sofistikuar të mundshme. Me rreth 36% të qytetarëve pjesëmarrës në zgjedhje – qeveria e fitoi legjitimitetin e vet politik. Paçka që as gjysma e votuesve nuk kanë votuar për te. Por, kush ju ka thënë se 37% e qytetarëve të Kosovës JANË qytetarët e Kosovës? Çka janë 63% i mbetur? Jo qytetarë? Apo, qytetarë të pandërgjegjshëm, siç klithin liberalët? As njëra, e as tjetra. Por, nëse na është kështu, unë me mburrje pozicionohem në grupin e qytetarëve të pandërgjegjshëm të Kosovës. Demokracia, ashtu si na prezantohet sot në Kosovë (por jo vetëm) nuk ka të bëjë me asgjë me të ashtuquajturën formulë se " shumica vendosë/qeverisë". Këtu është me rëndësi që shumica të MOS vendosë. Ose: shumicës nuk duhet t'i ndihet zëri. E zëri dhe artikulli i alternativës politike si aksion kolektiv, përfundimisht nuk bëhet nëpërmjet zgjedhjeve. Por kjo është problem tjetër.

Çka ka vendosur kjo pakicë e iluminuar, që e ka kryer "obligimin demokratik qytetar" për të votuar? Ajo ka vendosur asgjë më pak se sa zgjedhjen e Hashim Thaçit për kryeministër. Secili kalkulim tjetër është i panevojshëm (jo se alternativa ishte më e mirë, por kjo se bën atë më të mirin). Nuk është aspak me rëndësi se çfarë personi është Thaçi (duke iu referuar të gjitha etiketimeve [jo]publike për te – problemi nuk është tek personi i tij): çështja është çka përfaqëson ai; cili është kuptimi i tërë asaj strukture politike, shënjeshtë e të cilës është Thaçi; dhe poashtu, së fundi, por jo e fundit, çka nënkupton emri i tij si shënjeshtë politik?

Shënjeshtësi që shprehjen e vet shoqërore e gjen tek emri Thaçi, në fushën e politikës përfaqëson atë rrymë politike që njihet me emrin *reaksion*. Reaksioni është rryma më e rrezikshme politike, e siç na mëson Marks, ajo është edhe më e keqe se konservatorizmi, sepse synon kthimin mbresa të rrotës së historisë. Por, këtu do të kthehem më vonë. Shënjeshtësi politik i quajtur Thaçi, përfaqëson denjësisht atë strukturë politike që si fundament të platformës politike e ka pozicionin e Skllavit. Pozicioni i Skllavit në politikë është pozicioni i të degraduarit, i të nëpërkëmburit, i subjektit që e njih qenien e tij (në këtë rast politike) në nivel të jetës shtazore, e që kusht për ta mirëmbajtur këtë gjendje, është ekzistimi i Zotërisë së tij. Thaçi i ka njohur Zotërinjtë/Padronët e tij: Dukën Piter Faith dhe Dukeshën Tina Kaidanow. Thaçi është subjekt i vetvetëdijshëm për pozitën e tij. Në fakt, është vetëm kjo pozitë subjektive në të cilën qenia e tij politike mund të funksionojë. Revoltave të studentëve në

vitin '68, Jacques Lacan iu përgjigj kështu: "si subjekte historike, ju kërkoni një Padron të ri. Dhe do ta gjeni!" A nuk e bëri të njejtën bashkësia ndërkombëtare me ne? Para se të vinte në pushtet, Thaçi gjatë gjithë kohës ankohej e bërtiste për gjendjen shoqërore-politike të vendit. Histeria është problemi i shtrirjes së subjektit në rendin shoqëror, përkatësisht marrëdhënien që subjekti e ka me Tjetrin e madh *qua* rendi shoqëror simbolik. Histeriku e "jep" veten për *jouissance* [kënaqësinë] të Tjetrit – por triku është që ai nuk dëshiron të bëhet objekti i "realizimit" të dëshirës së Tjetrit, por vetëm ta mirëmbajë dëshirën e tij. Pyetjet e tij janë gjithnjë me përceptimin e tij nga Tjetri, si duket ai në vështrimin e Tjetrit, çka dëshiron Tjetri prej tij, etj. Si subjekt historik, Thaçi nuk ankohej për ta ndryshuar pozitën e vet subjektive karshi Padronit, sepse kjo do të nënkuptonte ndryshimin e subjektivitetit të vet, atë lartësim subjektiv të cilin raporti i tij me Tjetrin e madh nuk ia lejon. Ai ankohej për ta mirëmbajtur dëshirën e Tjetrit (në këtë rast Padronit) dhe për t'ia dëshmuar *jouissance* [kënaqjen] që ai përjeton nga të qenurit i dominuar. Por, Thaçi nuk është vetëm i dominuar: dhe këtu qëndron i tërë komplikimi. Pozita e tij është ajo e njëfarë skizofrenie politike: në raport me Padronët e tij, ai pozicionohet vullnetshëm si Skllavi, kurse në raport me qytetarët e Kosovës, ai e synon pozitën e Padronëve të tij – ai bëhet Padroni i qytetarëve të Kosovës.


Pra, kur liberalët tanë të përndritëruar kërkoniin zgjedhje, a nuk e kërkoniin një Padron të ri, të cilin bashkësia ndërkombëtare ua dhuroi? Ndaj kësaj dhurate politike, liberalët përsëri janë historikë: kërkoni një Padron të ri, pak më të butë, sepse ky ua cenon lirinë e shprehjes e të mediave. Për këtë, liberalët duhet të presin për vendimin e Padronëve të tyre tranzitiv-logjikë: Faith dhe Kaidanow. Është e dhimshme të jesh liberal.

Cili është dëmi shoqëror që Thaçi po i bën Kosovës? Dëmi i parë dhe më i madhi është i dyfishtë: 1) si kryeministër i Kosovës ai nuk përfaqëson as gjysmën e 37% të qytetarëve; 2) në emër të Kosovës dhe për Kosovën, ai e shpalli pavarësinë e vendit me Planin e Ahtisaarit si bazë politike të saj. Të gjitha veprimet e tjera janë pasoja të kësaj. Është shkruar e është thënë shumë për Planin e Ahtisaarit – janë bërë analiza të thella për dëshmërinë e këtij Plani. Pjesa e emancipuar e shoqërisë nuk la gjë pa bërë kundër këtij Plani. Pakica reaksionare na mundi edhe kësaj radhe. Por, përveç në planin politik, cili është dëmi i madh ekonomik që Thaçi, si student i zell-

shëm i Ahtisaarit do t'i sjellë Kosovës?

Privatizimi! Unë mendoj se privatizimi është rreziku më i madh politiko-ekonomik që i kanoset Kosovës. Duka Faith dhe Dukeshja Kaidanow na thonë se vetëm kështu mund të zhvillohemi ekonomikisht. Ne u themi në rregull, por pse mos ta luajmë lojën e njejtë së bashku: sikur ju në vendet e juaja të hiqni dorë nga nacionalizimi (ose blerja e aksioneve më të mëdha) të bankave që ose kanë falimentuar ose janë drejt falimentimit (si pasojë e krizës financiare) edhe ne do ta bëjmë të njejtën. Ata na thonë se nuk mund të funksionojmë jashtë kapitalizmit. Ne e aprovojmë këtë, sepse vërtetë është teze e saktë: por pse nuk i vendosim rregullat e njejtë të funksionimit të kapitalizmit? Por natyrisht se nuk pra-

pushtet nëpërmjet përqindjeve ose marrëveshjeve të tjera të pista që mesiguri do t'i bëjnë – a thua pse po nxitojnë t'i shesin kaq shpejtë ndërmarrjet publike? Privatizimi i deri tanishëm rezultoi me shkatërrimin e (pothuajse) të gjitha ndërmarrjeve shoqërore/publike dhe rritjen e mëtutjeshme të papunësisë dhe rrjedhimisht varfërisë. Andaj, argumentet se privatizimi sjellë punësim, zhvillim ekonomik, etj janë demantuar tërësisht dhe fuqishëm nga varfëria dhe papunësia në rritje dhe thellim të mëtutjeshëm nga privatizimi. Me urgjencën për të privatizuar gjithçka, a nuk po bëhet linjë zyrtare e qeverisjes thënia "Poshtë të varfërit, Lartë të pasurit"? Arroganca e kapitalizmit të instaluar në Kosovë me vullgaritetin e *neuveau riche* është e frikshme.



nojnë. E çka tjetër bën Thaçi përveç se aprovon gjithçka që i thonë? Por ne, 63%shi nuk duhet ta pranojmë këtë aprovim reaksionar.

Liberalët e moderuar na thonë se KEK-u, PTK-ja, Trepça, Aeroporti, etj nuk duhet të privatizohen tani dhe nuk duhet të privatizohen tërësisht, se shteti duhet të ketë aksione në këto kompani. Arsyetimi: si pasojë e krizës financiare, çmimi nuk do të jetë i levërdishëm, ato do të shiten shumë më lirë se sa çmimi real, etj etj. Kjo pikëpamje nuk është e rrezikshme sa pikëpamja e dukës e dukeshës. Por, te dyjat janë të dëmshme sepse synojnë privatizimin si opsionin e vetëm.

Privatizimi i ndërmarrjeve publike i sjellë Kosovës dëm të dyfishtë: 1) shitjen e pasurive të vendit, që nënkupton se ne i japim vendin korporatave multinacionale, i ftojme të na eksploatojnë, të pasurohen nëpërmjet eksploatimit të pasurive të vendit dhe fuqisë së lirë punëtore, dhe njëkohësisht, vendosjen e shtetit në shërbim të këtyre korporatave (nëpërmjet ndërrimit të legjislacionit, etj) dhe; 2) pasurimin e mëtutjeshëm të njerëzve në

Nëse mercenarët e kapitalizmit arrijnë t'i realizojnë projektet për privatizim – e sidomos privatizimin e ndërmarrjeve me rëndësi kapitale – atëherë unë mendoj se lirisht mund të hapim edhe për Kosovën. Sepse nëse na e kontrollojnë ekonominë, atëherë na e kontrollojnë shtetin. Një aktivist shoqëror-politik nga Tirana, para pak kohësh kishte thënë se privatizimi i këtyre ndërmarrjeve e humbë kuptimësinë e të gjitha aktiviteteve politike, e madje edhe të bashkimit kombëtar. Ç'kuptim ka shteti pa kontroll dhe pronësi mbi resurset kryesore të ekonomisë? A nuk jemi lodhur të gjithë nga shteti pa substancë i Kosovës: pa ekonomi, pa ushtri, pa kontroll mbi territorin shtetëror, një shtet që si synim ka luftimin e racizmit, aksiomë politike e ka racizmin (ndarjen në etni, etnifikimin territorial, etj).

Shumica e qytetarëve të Kosovës kanë arsye serioze të jenë në depresion. Arsyetja e depresionit tonë nuk është Thaçi si person; arsyeja e depresionit tonë kolektiv është Thaçi si *emër*. Është ajo frymë e politikës, shërbëtor zellshëm i së cilës është Thaçi.

TË SHITURIT PO NA SHESIN!

- Vitet 2009-2011 do të jenë vendimtare për pasurinë publike të Kosovës!
- Feronikeli dhe kompanitë tjera tregojnë se privatizimi i komputuar dëmton Kosovën miliona euro në vit!
- PTK-në, KEK-un, Trepçën si dhe Aeroportin e Prishtinës po i pret i njëjti fat!
- Politikanët po u shërbejnë interesave të kompanive të huaja e jo interesit të Kosovës!
- Politikanët tanë po shpërblejnë kompanitë Serbe me kontrata milionëshe e cila me parat tona po financon strukturat paralele!
- Përmes shkatërrimit të pasurisë së Kosovës, qeveritarët dhe kompanitë e huaja po pasurohen përdënisa varfëria po rritet!
- Shkatërrimi i pasurisë sonë po prezantohet si patriotizëm ekonomik!
- Ndërmarrjet e Kosovës janë pasuri e jonë e përbashkët!

**ÇOHU! kundër privatizimit që po
na varfëron!**



ANA E ERRËT E NJË TERMOCENTRALI QË PRODHON "DRITË"

KOSOVA!

2100 MW